



GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË
.....
Nr.20 / 22 SHTATOR 2011

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës e publikon : Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në mbështetje të Ligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-190.

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës publikohen: Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Vendimet e Gjykatës Kushtetuese; Dekretet e Presidentit të Republikës së Kosovës në rastet kur kërkohet nga Presidenti; Deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastet kur kërkohet nga Kryetari i Kuvendit; Aktet nënligjore të Qeverisë dhe të ministrive në rastet kur kërkohet nga Kryeministri dhe Aktet tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, si dhe INDEKS-i vjetor i Gazetës Zyrtare.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në pesë gjuhë: në gjuhën Shqipe, Angleze, Serbe, Turke dhe atë Boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës administrohet nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës:

Fitim Krasniqi

Drejtori i Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës:

Naser Canolli

Redaktori Përgjegjës i Gazetës Zyrtare:

Fehmi Stublla

Redaksia e Gazetës Zyrtare:

Hysen Bajramaj

Shqipe Fazliu-Gashi

Nergjivan Gjota

Besart Graiçevci

Adresa dhe Korrespondenca:

Ndërtesa e Re e Qeverisë,

Prishtinë

038-200-14039 / 038-200-14811

Ueb-faqja e Gazetës Zyrtare:

<http://gazetazyrtare.rks-gov.net>

E-mail adresa: Info-gzk@ks-gov.net

NË RAST MOSPËRPTHJE NDËRMJET VERSIONEVE GJUHËSORE TË AKTEVE JURIDIKE TË BOTUARA DHE TË PUBLIKUARA NË GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËRPARËSI DO TË KENË GJUHËT ZYRTARE NË PËRPTHJE ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

PËRMBAJTJA

LIGJI PËR MBI DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE
ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.....1

**LIGJI Nr. 04/L-033
PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME
AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR MBI DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE
ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Dhoma e Posaçme**

1. Që nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji:

1.1. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, më herët e themeluar me Rregulloren për Dhomën e Posaçme, riemërohet tani "Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit"; dhe

1.2. juridiksioni dhe kompetencat e Dhomës së Posaçme, si dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj, si dhe emërimin e gjyqtarëve që shërbejnë brenda saj, do të vendosen ashtu siç është përcaktuar me këtë ligj, i cili shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren për Dhomën e Posaçme.

2. Selia e Dhomës së Posaçme do të jetë në Prishtinë. Nëse Dhoma e Posaçme, apo ndonjë kolegji i saj vendos, dëgjimet për një çështje të caktuar mund të mbahen në vende të tjera.

3. Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 21 të Ligjit nr. 03/L-199 "mbi Gjykatat".

**Neni 2
Përkufizimet dhe referencat**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjenci** - Agjencia Kosovare e Privatizimit, e themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1.2. **Pasuri** - do të ketë kuptimin e përcaktuar me nenin 3 të Ligjit mbi AKP-në.

1.3. **Propozimi Gjithëpërfshirës** - Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007.

1.4. **Korporata** - do të ketë kuptimin e përcaktuar me nenin 3 të Ligjit mbi AKP-në.

1.5. **Vendim** - çdo vendosje, përveç Aktgjykimit, që merret apo lëshohet nga një gjykatë apo kolegji, nën-kolegji apo një gjyqtar i vetëm i Dhomës së Posaçme, si dhe përfshin, por pa u kufizuar në to, edhe vendimet apo urdhrat.

1.6. **Ndërmarrje** - do të ketë kuptimin e përcaktuar me nenin 3 të Ligjit mbi AKP-në.

1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

1.8. **Aktgjykim** - vendosja përfundimtare e dhënë apo e lëshuar nga një gjykatë apo koleg, nën-kolegj apo një gjyqtar i vetëm i Dhomës së Posaçme, i cili vendos të drejtat dhe detyrimet e palëve në një rast, edhe nëse një vendosje e tillë përfundimtare i nënshtrohet të drejtës së apelit;

1.9. **AKM** - Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, paraardhësja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

1.10. **Rregullorja e AKM-së** - Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12, e 13 Qershorit 2002, mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit;

1.11. **Person** - personi fizik, sipërmarrje apo autoritet publik;

1.12. **Autoritet publik** - organ ekzekutiv qeveritar, organ publik, ministri, departament, agjenci, apo autoritete tjera që ushtrojnë pushtete ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative publike apo gjyqësore. Termi «autoritet publik» gjithashtu përfshin edhe organizatat apo sipërmarrjet private deri në masën që ato ushtrojnë pushtetet e lartpërmendura, në bazë të një delegimi të autoritetit sipas ligjit, rregullores apo një akti nënligjor, apo në bazë të delegimit të autoritetit nga një Autoritet tjetër Publik;

1.13. **Ligji i AKP-së** - Ligji nr. 03/L-067, “mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit”, të datës 15 Qershor 2008, përfshirë edhe shtojcat e tij;

1.14. **Aksione** - aksionet, apo interesat tjerë pronësorë, në një Ndërmarrje apo Korporatë;

1.15. **Dhoma e Posaçme** - Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë e Privatizimit;

1.16. **Rregullorja e Dhomës së Posaçme** - Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13, e 13 Qershorit 2002, mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit; si dhe

1.17. **Sipërmarrje** - çdo ndërmarrje, korporatë, partneritet, ndërmarrje e përbashkët, person juridik, shoqatë, projekt, degë, zyrë, apo ndonjë organizatë apo grup tjetër i themeluar (pa marrë parasysh pronësinë, selinë apo vendin e aktivitetet apo themelimit të saj/tij).

2. Fjalët e përdorura në cilëndo gjini në këtë ligj do të përfshijnë edhe gjininë tjetër, derisa fjalët e përdorura në njëjës do të nënkuptohen të përfshijnë edhe shumësin, si dhe ato në shumës të përfshijnë edhe njëjësin.

3. Përveç nëse është e qartë që konteksti kërkon një interpretim tjetër, secila referencë në këtë ligj ndaj një ligji tjetër, rregulloreje të UNMIK-ut apo një akti nënligjor, apo ndonjë dispozite të caktuar të tij/saj, do të interpretohet me përfshirjen e ndryshimeve/plotësimeve të tyre. Nëse një ligj, rregullore apo akt i tillë nënligjor është shfuqizuar dhe zëvendësuar me legjislacion pasardhës që rregullon të njëjtën lëndë, ajo referencë – përveç nëse konteksti qartësisht kërkon interpretim tjetër – do të interpretohet të nënkuptojë atë legjislacion pasardhës, si dhe aty ku vlen, edhe dispozitat gjegjëse të tij.

4. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, secila referencë në cilindo element të ligjit të Kosovës ndaj Rregullores së Dhomës së Posaçme apo dispozitë(a) të veçanta të saj, do të interpretohet të nënkuptojë këtë ligj, si dhe aty ku vlen, dispozitën(at) gjegjëse të këtij ligji.

KREU II PËRBËRJA DHE ORGANIZIMI I DHOMËS SË POSAÇME

Neni 3 Përbërja, organizimi dhe emërimi

1. Dhoma e Posaçme do të përbëhet një numër i gjyqtarëve deri në njëzet (20), dymbëdhjetë (12) prej të cilëve do të jenë shtetas të Kosovës, derisa tete (8) do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë Së paku dy (2) nga gjyqtarët që janë shtetas të Kosovës do të jenë nga komunitetet pakicë.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës emëron, ri-emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Dhomës së Posaçme të cilët janë shtetas të Kosovës, me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Emërimi, ri-emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve që

janë shtetas të Kosovës bëhet në pajtim me të njëjtin proces dhe kërkesa që vlejné për emërimin, ri-emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.

3. Misioni Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes emëron, riemëron dhe shkarkon gjyqtarët ndërkombëtarë të Dhomës së Posaçme në pajtim me rregullat dhe procedurat e brendshme të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

4. Çdo person i cili është shtetas i Kosovës dhe që emërohet për të shërbyer si gjyqtar në Dhomën e Posaçme është i obliguar të bëjë të njëjtin betim si ai që është i obligueshëm për gjyqtarët e Gjykatës Supreme, të cilët janë shtetas të Kosovës.

5. Kryetari i Dhomës së Posaçme zgjidhet nga gjyqtarët e Dhomës së Posaçme.

6. Gjithë personat e emëruar për të shërbyer si gjyqtarë në Dhomën e Posaçme do të kenë arsimimin juridik dhe përvojën e gjerë dhe substanciale në ato fusha të lëndës ligjore që mbulohe nga kolegjet e ndryshme të specializuara të Dhomës së Posaçme.

7. Me kujdes të veçantë për pozitat e rezervuara për gjyqtarë ndërkombëtarë në Dhomën e Posaçme, gjithë kandidatët e propozuar për pozitat e tilla do të jenë gjerësisht të njohur nga komunitetet përkatëse juridike për kompetencën dhe integritetin e tyre. Përveç kësaj, kandidatët e tillë së bashku duhet të kenë një spektër të gjerë të arsimit dhe përvojës së gjatë dhe substanciale profesionale ligjore në fushat në vijim:

7.1. të drejtat pronësore;

7.2. të drejtat nga Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut, si dhe jurisprudenca në lidhje me të;

7.3. e drejta në bankrotim dhe insolvencë në juridiksionet që lejojnë debitorin të gëzojë posedimin dhe shfrytëzimin e një ndërmarrjeje gjatë procedurave të riorganizimit;

7.4. e drejta e shoqërive tregtare dhe qeverisjes korporative; si dhe

7.5. e drejta tregtare.

8. Dhoma e Posaçme do të ketë pesë kolegje të specializuara, si dhe një kolegji apeli. Kolegji i apelit do të ketë kompetencë ekskluzive apeli të shkallës së fundit mbi të gjitha çështjet brenda kompetencës së Dhomës së Posaçme.

9. Kryetari i Dhomës së Posaçme përcakton kompetencën primare të secilit kolegji të specializuar brenda Dhomës së Posaçme mbi njërin nga fushat vijuese:

9.1. kërkesat dhe çështjet tjera në lidhje me procesin e privatizimit;

9.2. kërkesat dhe çështjet tjera në lidhje me të drejtat e punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo sipas legjislacionit pasardhës që përcakton të drejtat e tilla;

9.3. kërkesat e përgjithshme pronësore dhe kreditore;

9.4. kërkesat dhe çështjet tjera në lidhje me likuidimin e një Ndërmarrjeje, të kryer nga AKM-ja në bazë të Rregullores së AKM-së, apo nga Agjencia në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit; si dhe

9.5. gjitha kërkesat dhe çështjet tjera që janë iniciuar sipas apo brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo ligjeve pasardhëse të saj, si dhe gjitha kërkesat, çështjet, rastet, lëndët dhe procedurat që dalin nga ose janë në lidhje me një rast sipas apo brenda fushëveprimit të një rregulloreje të tilla apo legjislacionit pasardhës; ky kolegji i specializuar mund të emërohet për të trajtuar edhe kërkesat sipas paragrafit 9.4 më lart.

10. Çdo kolegji i specializuar do të përbëhet nga një gjykatës ndërkombëtar dhe dy gjykatës që janë shtetas të Kosovës. Për secilin kolegji të specializuar, Kryetari i Dhomës së Posaçme, pas konsultimit me Presidentin e Kosovës dhe Misionin Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, emëron një gjykatës që të shërbejë si kryesues i kolegjit. Çdo kryesues i kolegjit mundet, me pëlqimin e Presidiumit, të delegojë përkohësisht funksionin e tillë tek një gjykatës tjetër i kolegjit të specializuar në fjalë.

11. Dhoma e Posaçme do të ketë Presidiumin e saj. Presidiumi do të përbëhet nga Kryetari dhe kryesuesit e pesë kolegjeve të specializuara. Presidiumi do të emërojë anëtarët tjerë të secilit kolegji të specializuar.

12. Kolegji i apelit do të përbëhet nga pese (5) gjykatës, tre (3) nga të cilët do të jenë gjykatës ndërkombëtarë dhe dy (2) do të jenë shtetas të Kosovës. Kryetari i Dhomës së Posaçme do të shërbejë si kryesues i kolegjit të apelit. Katër (4) anëtarët tjerë të kolegjit të apelit do të caktohen nga Kryetari i Dhomës së Posaçme pas konsultimit me Presidentin e Kosovës dhe Misionin Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

13. Kryetari i Dhomës së Posaçme vepron si kryesues i kolegjit të apelit. Kryetari i Dhomës së Posaçme mund të delegojë përkohësisht funksionin e kryesimit të tillë tek ndonjë gjykatës tjetër.

14. Kolegji i apelit do të ketë kompetencë ekskluzive të apelit në shkallë të fundit mbi të gjitha apelet nga Aktvendimet apo Aktgjykimet e kolegjeve të specializuara, apo nga cilado gjykatë në lidhje me lëndët apo rastet që i janë referuar më herët një gjykatë të tillë nga Dhoma e Posaçme.

15. Nëse gjyqtari dështon apo nuk është në gjendje të përmbushë detyrat e tij/saj rregullisht, Kryetari i Dhomës së Posaçme do ta informojë menjëherë Presidentin e Kosovës, Misionin Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

16. Në rast të dorëheqjes apo largimit të një gjyqtari, procesi i emërimit për zëvendësimin e tij/saj do të ndjekë të njëjtat procedura me procesin e emërimit të një gjyqtari që zëvendësohet.

Neni 4 Juridiksioni

1. Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim:

1.1. kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1.2. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë të cilat rrjedhin nga dështimi apo refuzimi i AKM-së apo Agjencisë për të kryer një akt apo për të përmbushur një obligim që kërkohet me ligj apo kontratë;

1.3. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim a veprim i ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, në bazë të autoritetit administrativ të përcaktuar me Rregulloren e AKM-së apo Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në lidhje me një Ndërmarrje apo Korporatë;

1.4. kërkesa kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së, apo Agjencisë;

1.5. kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me:

1.5.1. çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ;

1.5.2. pronësinë e një Ndërmarrjeje apo Korporate;

1.5.3. pronësinë mbi kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate, ose

1.5.4. çfarëdo prone apo pasurie në posedim apo kontroll të një Ndërmarrjeje apo Korporate, nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë;

1.6. kërkesa apo ankesa që kundërshtojnë apo sfidojnë cilindo aspekt të një liste zyrtare të punëtorëve me të drejtë legjitime të një Ndërmarrjeje, lëshuar nga AKM-ja apo Agjencia, sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo legjislacionit pasardhës që rregullon përpilimin e listave të tilla;

1.7. kërkesa në lidhje me likuidimin e një Ndërmarrjeje, që është kryer nga AKM-ja në bazë të Rregullores së AKM-së, apo nga Agjencia në bazë të Ligjit mbi AKP;

1.8. parashtrësja e bërë nga AKM-ja apo Agjencia në bazë të nenit 21 të Shtojcës A të Ligjit mbi AKP-në, për anulimin e një transaksioni të një Ndërmarrjeje që i është nënshtruar apo që i nënshtrohet likuidimit nga AKM-ja apo Agjencia.

1.9. ushtrimi i të drejtës apo autoritetit të AKM-së apo Agjencisë, nëse AKM-ja apo Agjencia ka parashtruar një parashtrësë në Dhomën e Posaçme për të kërkuar një ushtrim të tillë;

1.10. rasti apo procedura që del sipas apo brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo legjislacionit pasardhës të saj, apo një ankesë, lëndë, çështje apo procedurë që del apo është në lidhje me një rast sipas apo brenda fushëveprimit të rregullores apo legjislacionit të tillë;

1.11. çdo parashtrësë për vlerësimin dhe vendosjen e ligjshmërisë së një Aktgjykimi apo Aktvendimi të lëshuar nga një gjykatë tjetër në Kosovë në lidhje me kërkesat apo lëndët e përcaktuara me këtë paragraf 1;

1.12. shqyrtimi i një vendimi të marrë nga anëtarët ndërkombëtarë të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë për suspendimin e një vendimi të Bordit, në bazë të nenit 14.9 të Ligjit mbi AKP-në; si dhe

1.13. gjitha lëndët tjera që mund t'i parashtrohen Dhomës së Posaçme sipas ligjit.

2. Presidiumi i Dhomës së Posaçme do t'ia referojë secilin rast apo kërkesë që bie në fushëveprimin e paragrafit 1 të këtij neni kolegjit përkatës të specializuar, ndërsa ai kolegji i specializuar pastaj ka kompetencë primare brenda Dhomës së Posaçme mbi atë kërkesë apo lëndë. Nëse kolegji i specializuar ka marrë përsipër një rast që përmban një kërkesë të cilën kolegji e konsideron të jetë jashtë juridiksionit apo kompetencës së tij, ai kolegji i specializuar i kërkon Presidiumit t'ia caktojë atë kërkesë kolegjit të specializuar që ka juridiksionin apo kompetencën e nevojshme.

3. Kolegji i apelit në Dhomën e Posaçme do të ketë kompetencën ekskluzive të shqyrtimit dhe vendosjes së një lëndë që përmban një vendim sipas nën-paragrafit 1.12 të këtij neni, si dhe do të ndërmarrë atë shqyrtim dhe të lëshojë atë vendim në mënyrë urgjente.

4. Që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, as Dhoma e Posaçme, e as kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast specifik që është kompetencë primare e tyre tek gjykatat tjera të Kosovës. Për secilën kërkesë, lëndë, rast apo procedurë (bashkërisht të emëruara më tutje në tekst si: "lëndë") të referuar si të tilla para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji: (i) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, nuk ka marrë ndonjë Aktvendim substancial në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë pushon së pasuri kompetencë mbi lëndën dhe i kthen gjitha dokumentet dhe shkresat e lëndës tek Dhoma e Posaçme; (ii) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, ka marrë Aktvendim substancial në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë vazhdon të ketë kompetencë mbi lëndën, derisa Aktvendimet dhe Aktgjykimet në lidhje me atë lëndë i nënshtrohen shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur; (iii) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, ka nxjerrë Aktgjykim në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ai Aktgjykim i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur; por me kusht që nëse Dhoma e Posaçme hedh poshtë atë Aktgjykim, plotësisht apo pjesërisht, lënda(ët) në fjalë do t'i nënshtrohen rigjyqimit para kolegjit të specializuar të asaj lënde, e jo në gjykatën që ka lëshuar Aktgjykimin. Nëse Agjencia nuk është emëruar si palë në ndonjë lëndë që është në punë në ndonjë gjykatë sipas këtij paragrafi, gjykata në fjalë do të jetë e obliguar të emërojë Agjencinë si palë, ndërsa Agjencia do të ketë të drejtë të marrë pjesë plotësisht në lëndë si palë ex officio, si dhe do të marrë kopjen e plotë të gjitha shkresave të lëndës, si dhe do t'i dorëzohen gjitha parashtrësat, Aktvendimet dhe Aktgjykimet me shkrim, të parashtruara apo lëshuara në të ardhmen në atë lëndë apo procedurë. Nëse lënda është në shqyrtim e sipër në një gjykatë tjetër, ajo gjykatë nuk do të ketë autoritet si dhe nuk do të lëshojë asnjë Aktgjykim apo Aktvendim që do të shkelte apo do të ishte në mospërputhje me kufijtë e caktuar me nenin 11 të këtij ligji.

5. Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 më lart. Nëse një gjykatë ka ushtruar apo ka provuar të ushtrojë kompetencë apo autoritet mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast në kompetencën e Dhomës së Posaçme, derisa një lëndë apo kërkesë e tillë nuk është brenda kompetencës së asaj gjykate sipas paragrafit 4:

5.1. çdo Aktgjykim apo Aktvendim i lëshuar nga një gjykatë e tillë në lidhje me një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast, do të jenë të pavlefshme dhe të papërmbarueshme; ndërsa Dhoma e Posaçme, në bazë të parashtrësës së një personi, apo me iniciativën vetanake, do të lëshojë një urdhër me atë fuqi;

5.2. dhoma e Posaçme, me parashtrësë të një personi apo me iniciativë vetanake, do të urdhërojë atë gjykatë që të ndërpresë aktivitetet e veta në lidhje me kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin në fjalë; si dhe

5.3. dhoma e Posaçme, me parashtrësë të një personi apo me iniciativë vetanake, do të urdhërojë gjykatën në fjalë që t'ia bartë kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin Dhomës së Posaçme, në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni.

6. Asnjë gjë në këtë nen nuk paragjykon të drejtat e cilitdo person që jashtë Dhomës së Posaçme të ndjekë një rast apo lëndë që nuk përshkruhet me paragrafin 1 të këtij neni; me kushtin që Dhoma e Posaçme ka autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një lëndë specifike bie brenda fushëveprimit të paragrafit 1 të këtij neni.

7. Dhoma e Posaçme do të ketë autoritetin dhe juridiksionin, në bazë të parashtrësës nga personat e interesuar apo me iniciativë vetanake, për të lëshuar urdhër që i kërkon cilësdo gjykatë të Kosovës që t'ia bartë secilën kërkesë, lëndë, procedurë apo rast në punë në atë gjykatë tek Dhoma e Posaçme nëse:

7.1. përmbajtja e asaj kërkesë, lëndë, procedure apo rasti është brenda kompetencës ekskluzive të Dhomës së Posaçme, siç përcaktohet me paragrafin 1 të këtij neni; ose

7.2. një Ndërmarrje, Korporatë apo Agjenci është emëruar si palë në rastin apo procedurën në fjalë, apo që do të duhej – sipas ligjit të Kosovës – të emërohej si palë në rastin apo procedurën në fjalë.

Neni 5 Parashtruesit dhe palët kundërshtare

1. Parashtruesit, në procedurën para Dhomës së Posaçme, janë:

1. personi që pretendon të drejta pronësie apo posedimi apo interesa të tillë mbi apo në:

1.1.1. një Ndërmarrje apo Korporatë, apo kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate;

1.1.2. pasuritë në pronësi apo posedim të një Ndërmarrjeje apo Korporate, ose

1.1.3. pasuritë në posedim apo nën autoritetin administrativ apo mirëbesimin e Agjencisë;

1.1.4. Personi që pretendon të drejta kreditori, kontraktuale apo të drejta tjera ligjore;

1.1.5. ndaj një Ndërmarrjeje, Korporate apo Agjencisë;

1.1.6. mbi apo në Pasuritë në pronësi apo në posedim të një Ndërmarrjeje apo Korporate, apo

1.1.7. mbi apo në Pasuritë në posedim apo nën autoritetin administrativ apo të mbajtura në mirëbesim nga Agjencia;

1.2. personi që parashtron një kërkesë apo ankesë, siç përcaktohet me nën-paragrafin 1.6 të nenit 4 të këtij ligji;

1.3. Agjencia;

1.4. një Ndërmarrje;

1.5. një Korporatë; si dhe

1.6. secili person tjetër të cilin Dhoma e Posaçme apo ndonjë kolegji i saj e konsideron të domosdoshëm apo të përshtatshëm për ta pranuar me qëllim të sigurimit të gjykimit të plotë dhe të saktë të rastit apo çështjes në fjalë.

2. Palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme janë:

2.1. në kuptimin e kërkesës së përcaktuar me nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.6 apo 1.7 të nenit 4 të këtij ligji: Agjencia.

2.2. në kuptimin e kërkesës së përcaktuar me nën-paragrafët 1.4 apo 1.5 të nenit 4 të këtij ligji: sipas zgjedhjes së Agjencisë, Ndërmarrja/Korporata në fjalë, apo Agjencia duke vepruar në emër të Ndërmarrjes/Korporatës në fjalë;

2.3. në kuptimin e parashtresës për anulim të parashtruar apo dorëzuar nga Agjencia, si dhe përcaktuar me nën-paragrafin 1.8 të nenit 4 të këtij ligji: personi(at) që kanë interes material në transaksionin që i nënshtrohet një parashtrese të tillë;

2.4. në kuptimin e parashtresës për ushtrim të dorëzuar nga Agjencia, si dhe përcaktuar me nën-paragrafin 1.9 të nenit 4 të këtij ligji: personi(at) që i nënshtrohen asaj parashtrese; si dhe

2.5. në kuptimin e cilitdo rast apo çështje para saj: secili person të cilin Dhoma e Posaçme apo ndonjë kolegji i saj e konsideron të domosdoshëm apo të përshtatshëm për ta pranuar si Palë Kundërshtare me qëllim të sigurimit të gjyqimit të plotë dhe të saktë të rastit apo çështjes në fjalë.

3. Pa marrë parasysh dispozitat paraprake të këtij neni, në rastin apo procedurën e përcaktuar me nën-paragrafin 1.10 të nenit 4 të këtij ligji, personat që kanë të drejtë të marrin pjesë në atë rast apo procedurë, do të jenë ata që përcaktohen sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 apo legjislacionin pasardhës të tij, cilido ligj që të jetë në fuqi në atë kohë.

Neni 6

Periudha kohore për parashtrimin e kërkesës për kundërshtimin e vendimeve apo veprimeve të Agjencisë

1. Çdo person që kundërshton një vendim apo veprim të Agjencisë, i cili është ndërmarrë para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtojë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se nëntë (9) muaj pas datës kur ai person ka ditur, ose me vëmendje të arsyeshme do të duhej të kishte ditur për atë vendim apo veprim. Çdo kërkesë apo ankesë e tillë duhet përcjellë me prova që personi që parashtron një kërkesë apo ankesë të tillë i ka bërë një njoftim Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së parashtrimit, mbi qëllimin e atij personi që të parashtojë një kërkesë apo ankesë të tillë. Dhoma e Posaçme nuk do të pranojë kërkesën apo ankesën e tillë nëse nuk përcillet me ato prova, ose e cila parashtrohet pas kalimit të periudhës kohore të përmendur prej nëntë (9) muajsh.

2. Çdo person që kundërshton një vendim a veprim të Agjencisë, që është ndërmarrë në datën apo pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtojë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se njëqind e njëzet ditë (120) pas datës në të cilën vendimi apo veprimi i është dorëzuar personit në fjalë, ose, nëse një dorëzim i tillë nuk kërkohet me ligj, apo nëse dorëzimi i tillë nuk ka qenë i mundshëm apo i arritshëm përkundër përpjekjeve në mirëbesim nga Agjencia, i shpallur në pajtim me politikat operacionale të Agjencisë dhe dispozitat e nenit 10.3 të Ligjit mbi AKP-në. Dhoma e Posaçme nuk do të pranojë, si dhe do të refuzojë, secilin kundërshtim që parashtrohet pas kalimit të periudhës së përcaktuar prej njëqind e njëzet ditësh (120).

3. Personi i paditur nga Agjencia, apo një Ndërmarrje apo Korporatë, mund të parashtojë kundërpadi ndaj Agjencisë, apo Ndërmarrjes apo Korporatës, brenda afateve kohore në fuqi sipas ligjeve të Kosovës. Njoftimi i cili përcaktohet me nenin 30.2 të Ligjit mbi AKP-në nuk vlen për këtë kundërpadi.

4. Dispozitat e këtij neni si më lart nuk do të jenë të vlefshme për paditë dhe kundërpaditë që janë në fushëveprimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 apo legjislacionin pasardhës të saj. Dispozitat dhe afatet që rregullojnë parashtrimin e padive dhe kundërpadive të tilla do të jenë ashtu siç përcaktohen me atë rregullore apo legjislacionin pasardhës të saj, cilado të jetë në fuqi në atë kohë.

Neni 7

Rregullorja e Punës në Dhomën e Posaçme

1. Rregullat e procedurës të Dhomës së Posaçme janë ato të përcaktuara në Shtojcën e këtij Ligji. Presidiumi i Dhomës së Posaçme ka autoritetin të shpallë rregulla tjera procedurale siç e konsideron të domosdoshme apo të këshillueshme për të mundësuar kryerjen efikase dhe të rregullt të procedurave; me kusht që ato rregulla tjera procedurale të jenë në përputhje me këtë ligj si dhe Shtojcën e këtij ligji.

2. Pa marrë parasysh paragrafin 1 të këtij neni, rregullat procedurale që rregullojnë procedurat sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 apo legjislacionit pasardhës të saj, do të jenë ashtu siç përcaktohet me atë rregullore apo legjislacion pasardhës. Presidiumi i Dhomës së Posaçme, pas konsultimit me kolegjin e specializuar të ngarkuar me atë procedurë, do të ketë autoritetin për shpalljen e rregullave tjera procedurale të tilla, siç e konsideron të

domosdoshme apo të këshillueshme për të mundësuar kryerjen efikase dhe të rregullt të procedurave; me kusht që ato rregulla procedurale të jenë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 apo legjisllacionin pasardhës të saj, cilado të jetë në fuqi në atë kohë.

3. Rregullat tjera procedurale të shpallura nga Presidiumi sipas paragrafit 1 apo 2 të këtij neni gjithashtu duhet të jenë në përputhje me kushtet e vlefshme të së drejtës procedurale të vendosura me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 8 Paraqitja e provave

Në çdo procedurë, gjyqtari i rastit kolegji i Dhomës së Posaçme ka autoritetin të urdhërojë çdo person që të dorëzojë apo ofrojë prova dëshmuuese, dokumentare apo fizike, apo që të ofrojë ndryshe informata përkatëse, nëse gjyqtari i rastit ose kolegji me arsye beson që provat apo informatat e kërkuara kanë rëndësi materiale apo relevante për gjykimin e një rasti apo lëndë që është objekt i një procedure, apo të ndonjë çështjeje që del gjatë asaj procedure.

Neni 9 Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm

1. Çdo kolegji i specializuar i Dhomës së Posaçme mund të lëshojë urdhër për t'ia deleguar njërit prej anëtarëve të tij, apo një nën-kolegji që përbëhet nga dy anëtarë të tij, përgjegjësinë dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo procedurën e plotë për një rast që është juridiksion i fushës së tij. Aktgjykimet dhe Aktvendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm apo nën-kolegji i tillë do të konsiderohet të jetë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë.

2. Pala ka të drejtën e apelimit të Aktvendimeve apo Aktgjytimeve të një gjyqtari të vetëm apo nën-kolegji. Çdo apel i tillë bëhet drejtpërdrejt në kolegjin e apelit, në pajtim me dispozitat e paragrafit 6. të nenit 10 të këtij ligji, i cili rregullon parashtrimin e apeleve.

Neni 10 Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

1. Aktgjykimi në një rast nxirret dhe dorëzohet tek palët, me shkrim, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike pas datës në të cilën janë përmbyllur procedurat në fjalë.

2. Shqyrtimet e brendshme të secilit kolegji, në lidhje me një Aktvendim apo Aktgjykim, do të jenë të fshehta dhe nuk do të zbulohen.

3. Aktgjykimet dhe Aktvendimet e një kolegji miratohen me shumicë të votave.

4. Çdo Aktgjykim dhe aktvendim nxirret me shkrim, si dhe:

4.1. përmbledh sfondin procedural të rastit apo lëndës që është objekt i atij aktgjykimi apo aktvendimi;

4.2. përmban një prezantim të gjitha gjetjet faktike që kanë rëndësi materiale për rastin apo lëndën që është objekt i atij aktgjykimi apo aktvendimi;

4.3. ofron një shpjegim të qartë dhe të hollësishëm të bazës ligjore dhe arsyetimit të përdorur në arritjen e atij aktgjykimi apo aktvendimi; si dhe

4.4. nëse ai aktgjykim apo aktvendim i jep të drejtën për mjete juridike ndonjërisë palë, ofron shpjegim të qartë dhe të hollësishëm të bazës ligjore dhe arsyetimit të përdorur në dhënien e asaj të drejte.

5. Nëse pala ka parashtruar kërkesë apo ankesë, ndërsa gjyqtari i vetëm, nën-kolegji apo kolegji i specializuar në fjalë vendos, pas vlerësimit të vërtetësisë së pohimeve në parashtrësën e kërkesës apo ankesës, që ajo palë nuk ka të drejtë për mjete juridike në bazë të ligjit, ai gjyqtar i vetëm, nën-kolegji apo kolegji i specializuar do të nxjerrë, sipas nevojës, një vendim që hedh poshtë atë kërkesë pa mbajtur seancë për vlerësimin e provave, apo përndryshe pa lejuar ose kërkuar dorëzim të provave në lidhje me atë kërkesë.

6. Pala ka të drejtë të apelojë ndaj aktgjykimit apo aktvendimit të gjyqtarit të vetëm, nën-kolegjit apo kolegjit të specializuar – apo ndaj gjykatës që ka kompetencë mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast sipas paragrafit 4. të nenit 4 të këtij ligji – tek kolegji i apelit, duke parashtruar apelin tek kolegji i apelit dhe duke dorëzuar atë parashtrësë

tek palët tjera brenda njëzetën (21) ditësh. Apeli parashtrohet edhe para gjykatës, kolegjit të specializuar, nën-kolegjit apo gjyqtarit që ka nxjerrë aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë, brenda të njëjtës periudhë njëzetën (21) ditësh. Ky afat fillon të llogaritet prej mesnatës në atë ditë kur gjyqtari i vetëm, nën-kolegji, kolegji i specializuar apo gjykata i ka dorëzuar aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë palëve me shkrim. Kolegji i apelit refuzon apelin nëse pala dështon ta parashtrojë atë brenda periudhës së përcaktuar kohore.

7. Aktgjykimi apo aktvendimi në fjalë zbatohet apo hyn në fuqi vetëm pas periudhës njëzetën (21) ditësh të përcaktuar me paragrafin 6 të këtij neni, si dhe vetëm në rast se nuk ka pasur apel të parashtruar brenda asaj periudhe. Nëse apeli parashtrohet me kohë, në pajtim me paragrafin 6. aktgjykimi apo aktvendimi në fjalë nuk hyn në fuqi apo nuk zbatohet deri në nxjerrjen e një aktgjykimi apo aktvendimi nga kolegji i apelit mbi atë apel. Zbatueshmëria apo fuqia e aktgjykimit apo aktvendimit, e plotë apo e pjesëshme, mbi atë apel, është subjekt i aktgjykimit apo aktvendimit të nxjerrë nga kolegji i apelit mbi atë apel.

8. Në rast se pala parashtron apelin brenda afatit kohor të përcaktuar me paragrafin 6. të këtij neni, pala tjetër e procedurës në të cilën është nxjerrë aktvendimi apo aktgjykimi në fjalë do të ketë njëzetën (21) ditë, që nga data e dorëzimit të apelit tek ajo, t'i përgjigjet atij apeli apo cilitdo aspekt të tij, duke parashtruar tek kolegji i apelit, si dhe duke i dorëzuar edhe apeluesit dhe palëve tjera, përgjigjen e tij ndaj apelit.

9. Kur kolegji i apelit pranon apelin, më së pari përcakton nëse apeli meriton shqyrtimin. Nëse kolegji i apelit vendos që apeli nuk meriton shqyrtim, ai nxjerr dhe i dorëzon palëve aktgjykimin me shkrim i cili hedh poshtë apelin, bashkë me një shpjegim të hollësishëm të arsytimit ligjor përmes të cilit ka arritur tek aktgjykimi i tillë; në këtë rast, aktgjykimi apo aktvendimi që është subjekt i apelit bëhet i prerë dhe i plotfuqishëm, përveç në rastin e paragrafit 15. të këtij neni.

10. Në rastin kur kolegji i apelit vendos të pranojë apelin, ai mundet – sipas paragrafit 11. të këtij neni – të vërtetojë, hedhë poshtë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktgjykimin apo aktvendimin që është subjekt i apelit. Kolegji i apelit mundet edhe ta kthejë aktgjykimin apo aktvendimin, në plotësi apo pjesërisht, tek gjykata e shkallës më të ulët në fjalë (nëse lejohet sipas paragrafit 4. të nenit 4, kolegji i specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm për procedim të mëtutjeshëm, duke përfshirë procedurat e vlerësimit të dëshmiave. Kolegji i apelit mundet gjithashtu të urdhërojë edhe rigjykimin e kërkesës, lëndës, procedurës apo rastit, në plotësi apo pjesërisht, në të njëjtën gjykatë (nëse lejohet nga paragrafi 4 i nenit 4, kolegji, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm që ka nxjerrë aktgjykimin dhe aktvendimin në fjalë, ose nga një tjetër kolegji i specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm.

11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht:

11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegji i specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe

11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeluesi apo pala kundërshtare në parashtrësit e tij/saj me shkrim.

12. Nëse gjykata, kolegji i specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm dështon të nxjerrë aktvendim apo aktgjykim brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj, ose në rastet kur afatet e tilla kohore nuk janë përcaktuar me ligj, dështon ta nxjerrë brenda një kohe të arsyeshme, kolegji i apelit, në bazë të parashtrësës së palës, urdhëron gjykatën, kolegjin e specializuar, nën-kolegjin apo gjyqtarin e vetëm që të nxjerrë aktgjykimin apo aktvendimin në fjalë brenda dhjetë (10) ditësh pune. Nëse gjykata që ka kompetencë mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast në pajtim me paragrafin 4. të nenit 4 të këtij ligji nuk respekton atë urdhër, kolegji i apelit, në bazë të parashtrësës së palës apo me iniciativë vetanake, urdhëron bartjen e menjëhershme të atij rasti prapa tek Dhoma e Posaçme.

13. Gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet nxirren me shkrim dhe i vihen në dispozicion publikut. Nëse gjykata, kolegji, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm merr vendim verbal, ose lëshon një urdhër verbalisht, palët kanë të drejtë të kërkojnë që ai vendim apo urdhër të jepet me shkrim dhe t'i dorëzohet palëve.

14. Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.

15. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet ose zbatohet për të kufizuar ose për të tentuar për të kufizuar të drejtën kushtetuese të çdo personi për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në pajtim me ligjin dhe rregullat procedurale për një kërkesë të këtillë, për shqyrtimin e kushtetueshmërisë e cilitdo Vendim ose

Aktgjykim të lëshuar nga Dhoma e Posaçme ose cilado gjykatë tjetër.

Neni 11 Mjetet juridike

1. Pushteti dhe autoriteti i Dhomës së Posaçme për dhënien e mjeteve juridike dhe mjeteve tjera korigjuese në lidhje me ndonjë Ndërmarrje, Korporatë, Pasuri në pronësi apo posedim të një Ndërmarrjeje apo Korporate, apo ndonjë Pasuri që më herët apo aktualisht është nën administrimin e AKM-së apo Agjencisë, në bazë të autoritetit të përcaktuar me Rregulloren e AKM-së apo Ligjin mbi AKP-në, i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara me këtë nen.

2. Prej datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të respektojë dhe zbatojë parimin e përcaktuar me Aneksin VII, fusnota 5, pika 3 e Propozimit Gjithëpërfshirës që "Do të vazhdojë të zbatohet parimi i kompensimit në vend të kthimit fizik". Kur vendoset mjeti juridik që jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit mbi AKP-në, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen me preambulën e atij ligji.

3. Në rastet kur Dhoma e Posaçme vendos që njëra palë ka të drejtë, titull ose interes në apo mbi aksionin(et), apo interesa pronësie mbi një Ndërmarrje apo Korporatë, Pasuri në posedim të një Ndërmarrjeje apo Korporate, apo ndonjë pasuri tjetër mbi të cilën AKM-ja apo Agjencia ka ushtruar autoritetin e saj administrativ, si dhe aksioni(et), interesat pronësore apo Pasuria (apo të drejtat apo interesat mbi të) janë bartur tek një palë e tretë nga AKM-ja apo Agjencia në mirëbesim dhe në ushtrim apo veprim të arsyeshëm të autoritetit dhe përgjegjësive të veta administrative, sipas rregullores së AKM-së apo Ligjit mbi AKP-në:

3.1 Një bartje e tillë, në bazë të ligjit, do të jetë gjithsesi e vlefshme dhe obligative, dhe asnjë aspekt i asaj bartjeje nuk do të preket nga një vendosje e tillë; si dhe

3.2 Ajo palë do të ketë të drejtë vetëm të kompensimit adekuat monetar për humbjen e të drejtës, titullit apo interesit të tillë. Madhësia e një kompensimi të tillë do të përcaktohet në bazë të vlerës së transaksionit të kryer nga AKM-ja apo Agjencia të aksionit(ëve) apo Pasurisë në fjalë; derisa shkalla e kënaqshmërisë së atij kompensimi është subjekt i dispozitave në fuqi të Ligjit mbi AKP-në.

4. Për qëllimet e paragrafit 3., nëse AKM-ja ose Agjencia – në mirëbesim dhe në ushtrim apo veprim të arsyeshëm të autoritetit dhe përgjegjësive të saj sipas Rregullores së AKM-së apo Ligjit mbi AKP-në – ka bartur aksionin(et), ose interesin(at) pronësore të apo në një Ndërmarrjeje apo Korporate, tek një palë e tretë, gjitha Pasuritë në posedim të Ndërmarrjes apo Korporatës në kohën e asaj bartjeje do të konsiderohet të jetë pronë e ligjshme e asaj Ndërmarrjeje apo Korporate që prej datës së asaj bartjeje, përveç nëse një posedim i tillë është fituar në bazë të kushteve të një kontrate me shkrim që qartësisht tregon që Pasuria nuk është pronë e Ndërmarrjes apo Korporatës.

5. Asnjë person nuk ka të drejtë ndaj apo nuk do të fitojë mjete juridike apo korigjim që do të kërkonte apo përfshinte shfuqizimin, anulimin, pengimin apo modifikimin e një transaksioni apo kontrate (apo ndonjë të drejte, përfitimi apo obligimi që del nga apo bazohet në një transaksion apo kontratë) që është nënshkruar apo marrë përsipër me një palë të tretë nga AKM-ja apo Agjencia në bazë të ushtrimit në mirëbesim të autoritetit të përcaktuar me Rregulloren e AKM-së apo Ligjin mbi AKP-në.

6. Mjetet juridike kundër Agjencisë në veprim drejtpërdrejt në kapacitetin e saj i nënshtrohen dispozitave të nenit 18 të Ligjit mbi AKP-në.

7. Pa marrë parasysh dispozitat tjera të këtij ligji, shprehimisht përcaktohet që nëse një Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar procedurave sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 apo ndonjë ligji pasardhës të saj, mjetet juridike dhe korigjimi që është dhënë apo imponuar nga Dhoma e Posaçme në lidhje me atë Ndërmarrje apo Korporatë, apo ndonjë Pasuri në pronësi apo posedim të asaj Ndërmarrjeje apo Korporate, do të kufizohet në mjetet juridike dhe korigjuese të specifikuar në atë rregullore apo legjisllacionin pasardhës të saj.

Neni 12 Shpenzimet

Çdo aktgjykim që nxirret nga një gjyqtar i vetëm, kolegji i specializuar apo nën-kolegj do t'i ndajë shpenzimet e procedurave në fjalë mes palëve, me të drejtë apo me arsye sipas rrethanave. Shpenzimet e ndara kështu mund të përfshijnë tarifën gjyqësore dhe tarifën e arsyeshme të avokatit dhe shpenzimet tjera që brenda arsyes janë bërë nga një palë në ndjekjen e mbrojtjes apo kërkesës, kundërpadsë apo ndonjë faze tjetër në procedurën në fjalë. Ndarja e tillë mund të kërkojë që pala e pasuksesshme të paguajë shpenzimet e bëra brenda arsyes nga pala fituese në realizimin apo mbrojtjen e asaj kërkesë, kundërpadie apo rasti tjetër. Përveç dispozitave mbi kalkulimin dhe ndarjen e

shpenzimeve që përcaktohen me rregullat procedurale të cilat janë parashikuar me Shtojcën e këtij ligji, presidiumi mund të shpallë rregulla më të hollësishme mbi shpenzimet në bazë të autoritetit që ka sipas nenit 7 të këtij ligji.

KREU III DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13 Zgjatja e afateve të dhëna kohore

Çdo kolegji, nën-kolegji apo gjyqtar i vetëm, por vetëm në rrethana tejet të jashtëzakonshme, si dhe vetëm për arsye shumë të bazuara, mund të zgjasë afatet kohore apo periudhat e përcaktuara me këtë ligj apo në shtojcën e tij, për aq kohë sa konsiderohet e arsyeshme brenda rrethanave.

Neni 14 Shfuqizimi i ligjeve të mëparshme; konfliktet; interpretimi

1. Ligji shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren për Dhomën e Posaçme, bashkë me aktet nënligjore të shpallura sipas saj, të cilat – prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji – nuk do të kenë apo nuk marrin forcë apo fuqi; megjithatë, me kusht që nëse një rast që është në punë në Dhomën e Posaçme në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka arritur një fazë të avancuar procedurale dhe gjykimi i duhur i atij rasti kërkon vazhdimin e zbatimit të dispozitave procedurale të Rregullores së Dhomës së Posaçme, apo të akteve nënligjore që dalin nga ajo, atëherë Dhoma e Posaçme mund të zbatojë ato dispozita procedurale deri në masën e domosdoshme për të siguruar një gjykim të tillë të duhur.

2. Dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi secilën dispozitë që nuk përputhet me të në cilëndo rregullore, ligj apo akt tjetër nënligjor; duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Ligjin nr. 03/L-053 "Mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë"; megjithatë, me kusht që në rast të ndonjë konflikt mes këtij ligji dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo të legjislacionit pasardhës të saj, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 apo legjislacioni pasardhës i saj, cilado që të jetë në fuqi në atë kohë, do të mbizotërojë.

3. Vendimi ekzekutiv nr. 2008/34 "mbi suspendimin e përkohshëm të gjitha aktiviteteve në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit", lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK-ut, nuk do të ketë fuqi apo forcë prej datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Neni 15 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar 2012.

**Ligji Nr. 04/L-033
31 gusht 2011**

Shpallur me dekreten Nr.DL-026-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

**SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-033
PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME
AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

**RREGULLORJA E PUNËS
E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Fushëveprimi**

Rregullat procedurale të përcaktuara me këtë Shtojcë rregullojnë procedurat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë e Privatizimit, të ndërmarra në lidhje me rastet dhe lëndët brenda kompetencës së saj, siç përcaktohet me nenin 4 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme.

**Neni 2
Përkufizimet dhe referencat**

1. Për qëllime të interpretimit dhe zbatimit të kësaj Shtojce, vlejné termet dhe përkufizimet e tyre të përcaktuara me nenin 2 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e Agjencisë së Privatizimit.

2. Përveç këtyre, termet e përkufizuara në vijim do të kenë kuptimin e dhënë:

2.1. **Kolegji i apelit**, do të thotë kolegji i apelit të Dhomës së Posaçme, themeluar në bazë të paragrafit 7. të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme;

2.2. **Parashtrues**, do të thotë personi i referuar në paragrafin 1. të nenit 5 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, i cili ka parashtruar një kërkesë apo ankesë tek Dhoma e Posaçme;

2.3. **Pala** do të thotë Parashtrues apo Palë Kundërshtare;

2.4. **Kryetar**, do të thotë Kryetari i Dhomës së Posaçme, i zgjedhur në pajtim me paragrafin 4. të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme;

2.5. **Presidium**, do të thotë Presidiumi i Dhomës së Posaçme, themeluar në bazë të paragrafit 10 të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme;

2.6. **Kryesues i Kolegjit**, do të thotë: në rastin e Kolegjit të Apelit, Kryetari i Dhomës së Posaçme, siç përcaktohet me paragrafin 12. të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme ose gjyqtari ndërkombëtar të cilit përkohësisht i është deleguar funksioni i tillë në bazë të fjalisë së dytë të atij paragrafi; si dhe në rastin e Kolegjit të Specializuar, gjyqtari ndërkombëtar i caktuar si Kryesues i atij Kolegji të Specializuar, në bazë të paragrafit 9 të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, ose gjyqtari ndërkombëtar të cilit përkohësisht i është deleguar funksioni i tillë në bazë të fjalisë së tretë të atij paragrafi;

2.7. **Gjyqtar i vetëm**, do të thotë një gjyqtar i vetëm ndërkombëtar tek i cili kolegji i specializuar ka bartur përgjegjësinë dhe autoritetin e udhëheqjes së procedurës për një rast brenda kompetencës lëndore të atij kolegji, në bazë të paragrafit 1. të nenit 9 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme;

2.8. **Ligji mbi Dhomën e Posaçme**, do të thotë ligji, pjesë e të cilit është edhe kjo Shtojcë;

2.9. **Kolegji i Specializuar**, do të thotë një kolegji i specializuar i Dhomës së Posaçme, themeluar në bazë të paragrafit 7. të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme;

2.10. **Nën-kolegj**, do të thotë një nën-kolegj i Kolegjit të Specializuar, tek i cili Kolegji i Specializuar ka deleguar përgjegjësinë dhe autoritetin e udhëheqjes së procedurës për një rast brenda kompetencës lëndore të atij kolegji, në bazë të paragrafit 1. të nenit 9 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme;

2.11. **Pala kundërshtare**, do të thotë një person i referuar tek paragrafi 2. i nenit 5 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme; si dhe

2.12. **Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13**, do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13, e datës 9 maj 2003, mbi Transformimin e të Drejtës së përdorimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore.

3. Fjalët e përdorura në cilëndo gjini në këtë ligj do të përfshijnë edhe gjininë tjetër, derisa fjalët e përdorura në njëjës do të nënkuptohen të përfshijnë edhe shumësin, si dhe ato në shumës të përfshijnë edhe njëjësin.

4. Përveç nëse është e qartë që konteksti kërkon një interpretim tjetër, secila referencë në këtë Shtojcë ndaj një ligji tjetër, rregulloreje të UNMIK-ut apo një akti nënligjor, apo ndonjë dispozite të caktuar të tij/saj, do të interpretohet me përfshirjen e ndryshimeve/plotësimeve të tyre. Nëse një ligj, rregullore apo akt i tillë nënligjor është shfuqizuar dhe zëvendësuar me legjislacion pasardhës që rregullon të njëjtën lëndë, ajo referencë – përveç nëse konteksti qartësisht kërkon interpretim tjetër – do të interpretohet të nënkuptojë atë legjislacion pasardhës, si dhe aty ku vlen, edhe dispozitat analoge të tij.

5. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, secila referencë ndaj cilitdo element të ligjit të Kosovës ndaj Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2008/6 apo të ndonjë dispozite të caktuar të saj, do të interpretohet duke nënkuptuar këtë Shtojcë, si dhe aty ku vlen, dispozitat analoge të kësaj Shtojce.

6. Secila referencë në këtë Shtojcë ndaj «legjislacionit pasardhës» do të thotë legjislacion i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe dekretuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KREU II GJYQTARËT E DHOMËS SË POSAÇME

Neni 3 Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme

Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme, duke përfshirë Kryetarin e saj, do të plotësojnë kërkesat minimale të kompetencës dhe ekspertizës profesionale, të përcaktuar me paragrafët 5. dhe 6. të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme.

Neni 4 Mospërputhjet dhe përjashtimet gjyqësore

1. Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme nuk mund të mbajnë pozita tjera publike apo administrative. Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme nuk mund të mbajnë as mandate e as pozita në parti politike, e as të angazhohen në aktivitete politike apo aktivitete tjera të partisë politike. Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme nuk mund të angazhohen në asnjë aktivitet apo punë të natyrës profesionale, pa marrë parasysh nëse ai aktivitet apo punë kompensohet apo jo, e as të angazhohen në asnjë aktivitet që nuk është në përputhje me funksionet e tij apo saj.

2. Asnjë gjyqtar i Dhomës së Posaçme nuk mund të marrë pjesë në rastet apo procedurat në të cilat ai apo ajo:

2.1. ka marrë pjesë më herët si agjent apo këshilltar;

2.2. është punësuar më herët, ka vepruar apo ka ofruar shërbime për ndonjërin prej palëve;

2.3. ka marrë pjesë më herët si anëtar i një gjykate, tribunali apo komisioni hetimor, apo që ka vepruar në ndonjë kapacitet tjetër të ngjashëm, përveç si gjyqtar i Dhomës së Posaçme;

2.4. ka lidhje të gjakut apo përmes martesës me ndonjërin prej palëve, ose në rastin kur pala është një sipërmarrje, ka lidhje të gjakut apo përmes martesës me cilindo person që është pronar apo kreditor i asaj sipërmarrjeje, apo ndonjë person që është anëtar i bordit apo menaxhmentit të një sipërmarrjeje të tillë; ose

2.5. ka apo fiton një interes direkt apo indirekt në ndonjë sipërmarrje që është palë në rast apo procedurë, apo në ndonjë subjekt që kërkon interes pronësor në një sipërmarrje që është palë në rast apo procedurë; ose

2.6. është subjekt i ndonjë konflikti interesash, real apo të supozuar, që do të pengonte, apo që do të supozohej të pengonte, aftësinë e tij/saj që të gjykojë rastin apo procedurën në mënyrë profesionale dhe objektive.

3. Gjyqtari do të ketë detyrë absolute të kërkojë përjashtimin nëse paraqitet ndonjëri prej kushteve të përcaktuara me paragrafin 2.

4. Presidiumi i Dhomës së Posaçme, në ushtrimin e autoritetit të tij sipas nenit 10 të kësaj Shtojce, mund të përjashtojë secilin gjyqtar të Dhomës së Posaçme nga pjesëmarrja në gjykimin e rastit apo procedurës, ose me kërkesë të atij gjyqtari apo me kërkesë të ndonjë pale. Kërkesa për përjashtim të një gjyqtari mund të bëhet në çdo kohë gjatë shqyrtimit të rastit apo procedurës.

5. Kërkesa për përjashtim nga një gjyqtar do të trajtohet nga Kryesuesi i Kolegjit, i cili e njofton Presidiumin me kërkesën. Nëse kërkesa për përjashtim bëhet nga vetë Kryesuesi i Kolegjit, ajo do të trajtohet drejtpërdrejt nga Presidiumi. Nëse Presidiumi lejon përjashtimin sipas kërkesës, gjyqtari në fjalë zëvendësohet për rastin apo procedurën në fjalë me gjyqtarin zëvendësues, i cili do të transferohet për këtë qëllim nga rendi i gjyqtarëve në shërbim. Zëvendësimi i gjyqtarit ndërkombëtar do të jetë gjyqtar ndërkombëtar, derisa zëvendësimi i gjyqtarit vendor do të jetë gjyqtar vendor.

KREU III ZYRA E REGJISTRIMIT

Neni 5 Zyra e regjistrimit

1. Dhoma e Posaçme e ka zyrën e vet të regjistrimit, të ndarë nga Zyra e regjistrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
2. Në Zyrën e regjistrimit do të mbahet një regjistër ku do shënohen të gjitha parashtresat dhe dokumentet mbështetëse sipas radhës që parashtrohen.
3. Çdo person mund ta konsultojë regjistrin në Zyrën e regjistrimit dhe mund të marrë kopje të ekstrakteve të regjistrit, me përjashtim të dokumenteve të cilat janë shpallur konfidenciale me urdhër të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme pas pagesës së një shume të cilën e cakton Presidiumi.
4. Zyra e regjistrimit të Dhomës së Posaçme mund të kërkojë ndihmë nga cilado gjykatë tjetër në Kosovë dhe ajo ndihmë i ofrohet, me qëllim të përmbushjes së detyrave të veta.

Neni 6 Detyrat e regjistërmbajtësit të Dhomës së Posaçme

1. Regjistër mbajtësi dhe zëvendës regjistër mbajtësi, zgjidhen dhe emërohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
2. Para marrjes së detyrës, regjistër mbajtësi dhe zëvendës regjistër mbajtësi do të betohen apo do të japin deklaratën vijuese solemne pranë Dhomës së Posaçme: "Unë solemnisht deklaroj se funksionet me të cilat ngarkohem si regjistër mbajtës/ zëvendës regjistër mbajtës i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit do t'i kryej me besnikëri, mençuri dhe ndërgjegje dhe do t'i mbajë të fshehta e konfidenciale të gjitha informacionet që do t'i marr gjatë ushtrimit të funksioneve të mia".
3. Nën autorizimin e Kryetarit të Dhomës së Posaçme, regjistër mbajtësi dhe zëvendës regjistër mbajtësi do ta ndihmojnë Dhomën e Posaçme në ushtrimin e funksioneve të veta dhe do të jenë përgjegjës për organizimin dhe aktivitetet e zyrës së regjistrimit. Ata gjithashtu do të jenë përgjegjës që të mbikëqyrin përgatitjen e procesverbalit nga procesmbajtësi për procedurat gjyqësore të Dhomës së Posaçme .
4. Regjistër mbajtësi dhe zëvendës regjistër mbajtësi do ta ruajnë vulën dhe arkivin e Dhomës së Posaçme dhe do të shërbejnë si kanal për të gjitha komunikimet dhe njoftimet e bëra nga Dhoma e Posaçme apo ato që i janë adresuar asaj lidhur me rastet që janë parashtruar ose do të parashtrohen pranë kësaj Dhome.
5. Në varësi të detyrimit për ruajtjen e diskrecionit të kësaj zyre, regjistër mbajtësi dhe zëvendës regjistër mbajtësi do t'ju përgjigjen kërkesave për dhënie të informacioneve lidhur me punën e Dhomës së Posaçme.
6. Puna dhe organizimi i zyrës së regjistrimit do të rregullohet me udhëzimet e përgjithshme të përpiluara nga regjistër mbajtësi dhe zëvendës regjistër mbajtësi, të miratuar nga Dhoma e Posaçme .
7. Presidiumi i Dhomës së Posaçme mund të kërkojë që të betohen apo solemnisht të deklarohen edhe punëtorët tjerë

që punojnë për Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni.

KREU IV ORGANIZIMI I DHOMËS SË POSAÇME

Neni 7 Organizimi; Sesioni i përhershëm

Dhoma e Posaçme organizohet në pajtim me dispozitat e nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe mbetet gjithmonë në sesion.

Neni 8 Administrata nën udhëzimet e Presidiumit

Presidiumi i Dhomës së Posaçme do të udhëzojë administratën e Dhomës së Posaçme dhe, përveç nëse nuk parashikohet ndryshe me këtë Shtojcë, edhe punën e saj gjyqësore.

Neni 9 Kryesuesit e Kolegjeve

Çdo Kolegj i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme do të ketë Kryesues të Kolegjit në bazë të paragrafëve 9 dhe 12 të nenit 2 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme. Kryesuesit e Kolegjeve drejtojnë punën gjyqësore të kolegjit dhe kryesojnë dëgjimet dhe shqyrtimet, përveç nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe me këtë Shtojcë.

Neni 10 Presidiumi i Dhomës së Posaçme

1. Presidiumi:

1.1. shpall rregulla dhe bën vendosje për caktimin e lëndëve të Kolegjeve të Specializuara deri në masën që kjo nuk përcaktohet me dispozitat e Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, Ligjit nr. 03/L-053 "mbi Kompetencën, Zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë", apo të kësaj Shtojcë;

1.2. jep udhëzime mbi zëvendësimin e gjyqtarëve, vendos mbi kërkesat për përjashtimin e një gjyqtari, si dhe përcakton kriteret që duhen përmbushur nga Kolegji i Specializuar kur i bart kryerjen e procedurave një Nën-kolegji apo Gjyqtari të Vetëm;

1.3. në pajtim me paragrafin 1. të nenit 7 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, miraton dhe shpall rregulla shtesë dhe udhëzime praktike; veçanërisht në lidhje me procedurat e veçanta sipas neneve 68 deri në 70 të kësaj Shtojcë;

1.4. lëshon vendime procedurale për lëndët apo çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht me këtë Shtojcë, të cilat qartësojnë apo plotësojnë këtë Shtojcë, apo ato që lëshohen sipas nën-paragrafit 1.3 të këtij neni; si dhe

1.5. kryen funksionet tjera të përcaktuara për Presidiumin sipas Ligjit mbi Dhomën e Posaçme.

2. Rregullat procedurale mbi mënyrën në të cilën caktohen rastet për Kolegjet e Specializuara në pajtim me nën-paragrafin 1.1 do të shpallen për çdo vit kalendarik nga Presidiumi, në fillim të atij viti kalendarik. Rregullat e tilla mund të ndryshohen vetëm gjatë vitit kalendarik nëse Kolegji i Specializuar ngarkohet tepër për shkak të mungesës afatgjate të njërit apo më shumë gjyqtarëve të tij.

3. Presidiumi merr vendime me shumicë të thjeshtë të kuorumit. Kuorumi ekziston nëse tre apo më shumë anëtarë të Presidiumit janë të pranishëm. Nëse Presidiumi nuk arrin të marrë vendim me kohë, Kryetari shpall atë vendim dhe ia paraqet Presidiumit për miratim. Secili vendim i marrë nga Kryetari mbetet në fuqi deri sa Presidiumi të vendosë ndryshe.

4. Vendosja nga Presidiumi mbi mënyrën në të cilën caktohen rastet për Kolegjet e Specializuara do të përcaktohet me një dokument konciz që i jepet edhe Regjistermbajtësit. Regjistermbajtësi publikon dokumentin sapo ta pranorë

atë nga Presidiumi.

5. Vendimet procedurale të Presidiumit sipas nën-paragrafit 1.4 të këtij neni marrin formën e një Aktgjykimi procedural të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme, i cili nuk mund të apelohej.

6. Regjistër mbajtësi publikon menjëherë, në faqen e internetit të Dhomës së Posaçme, rregullat tjera, vendimet procedurale apo udhëzimet praktike të nxjerra nga Presidiumi, në bazë të nën-paragrafëve 1.3 apo 1.4 të këtij neni.

Neni 11 Nën-kolegjet dhe Gjyqtarët e Vetëm

1. Kërkesa, ankesa apo lënda që parashtrohet tek Dhoma e Posaçme i caktohet menjëherë Kolegjit më të përshtatshëm të Specializuar në pajtim me nenin 12 të kësaj Shtojce, si dhe rregullat procedurale të shpallura nga Presidiumi në bazë të nenit 10 të kësaj Shtojce. Kryesuesi i Kolegjit vendos nëse kryerja e procedurave duhet t'i delegohet një nën-kolegji apo gjyqtari të vetëm në pajtim me nenin 9 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme. Nëse pas respektimit të kriterëve të përcaktuara me nën-paragrafin 1.2 të nenit 10 të kësaj Shtojce, Kryesuesi i Kolegjit vendos t'i caktojë kryerjen e procedurës një nën-kolegji apo gjyqtari të vetëm, Kryesuesi i Kolegjit nxjerr një urdhër që përcakton shkallën e përgjegjësisë dhe autoritetit të atij nën-kolegji apo gjyqtari të vetëm, duke përfshirë edhe përshkrimin e shkallës së autoritetit të nën-kolegjit apo gjyqtarit të vetëm për të nxjerrë aktvendime dhe aktgjykime në procedurat e deleguara.

2. Në nën-kolegji, gjyqtari ndërkombëtar vepron si Kryesues. Gjitha aktvendimet dhe aktgjykimet e nxjerra nga nën-kolegji miratohen me konsensus. Nëse nuk mund të arrihet konsensusi, secili anëtar i nën-kolegjit mund t'ia referojë lëndën Kolegjit të plotë të Specializuar.

3. Gjyqtari i Vetëm mund të nxjerrë aktvendime dhe aktgjykime vetëm brenda autoritetit të tij/saj të përcaktuar me urdhrin e Kryesuesit të Kolegjit që i cakton procedurën në fjalë Gjyqtarit të Vetëm.

4. Çdo aktgjykim apo aktvendim i një nën-kolegji apo një gjyqtari të vetëm konsiderohet si aktgjykim apo aktvendim i Kolegjit të Specializuar në fjalë, si dhe i nënshtrohet apelit në Kolegjin e Apelit, në pajtim me dispozitat përkatëse të kësaj Shtojce, ose nëse zbatohen, edhe rregullave tjera të nxjerra në bazë të nën-paragrafit 1.3 të nenit 10 të kësaj Shtojce.

KREU V KOMPETENCA PRIMARE E KOLEGJEVE TË SPECIALIZUARA

Neni 12 Kompetencat primare dhe caktimi i lëndëve

1. Lënda i caktohet Kolegjit të Specializuar që ka kompetencë primare mbi atë rast, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 8. të nenit 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme. Sipas kësaj kompetence:

1.1. rastet që kanë të bëjnë me kërkesa apo ankesa që dalin apo kanë lidhje me procesin e privatizimit të ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia i referohen Kolegjit të Specializuar që ka kompetencë për çështjet që lidhen me privatizimin;

1.2. rastet që kanë të bëjnë me kërkesa apo ankesa në lidhje me të drejtat legjitime të punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores Nr. 2003/13, apo legjislacionin pasardhës të saj, apo çështjet e përgjithshme të punësimit të një Ndërmarrjeje apo Korporate, i referohen Kolegjit të Specializuar që ka kompetencë për çështjet në lidhje me të drejtat legjitime të punëtorëve;

1.3. rastet që kanë të bëjnë me kërkesa të përgjithshme të pronësisë apo kreditore në lidhje me një Ndërmarrje apo Korporatë që nuk është pjesë e fushëveprimit të nën-paragrafit 1.1 të këtij neni, i referohet Kolegjit të Specializuar që ka kompetencë për kërkesa të përgjithshme të pronësisë apo kreditore;

1.4. rastet që kanë të bëjnë me ankesa apo çështje tjera që dalin apo kanë lidhje me likuidimin e një Ndërmarrjeje apo pasurive të saj i referohen një Kolegji të Specializuar që ka kompetencë për çështjet në lidhje me likuidimin e Ndërmarrjeve; dhe

1.5. rastet që kanë të bëjnë me riorganizimin apo ristrukturimin e një Ndërmarrjeje në bazë të Rregullores nr.

2005/48, apo legjislacionit pasardhës të saj, i referohen Kolegjit të Specializuar që ka kompetencë për riorganizimin apo ristrukturimin e Ndërmarrjeve.

2. Rastet që kanë të bëjnë me kërkesa apo ankesa për të cilat asnjë Kolegj i Specializuar nuk ka kompetencë primare, apo për të cilat nuk është caktuar Kolegji i Specializuar në kohën kur është parashtruar kërkesa apo ankesa, do të trajtohen nga një Kolegj i Specializuar i caktuar sipas rregullave shtesë të nxjerra në pajtim me nën-paragrafin 1.3 të nenit 10 të kësaj Shtojce.

3. Rregullat shtesë të nxjerra nga Presidiumi sipas nën-paragrafit 1.3 të nenit 10 të kësaj Shtojce mund të lejojnë caktimin e një lënde tek një Kolegj tjetër i Specializuar, ndryshe nga ai që përcaktohet me paragrafin 1 të këtij neni, nëse ka rrethana të veçanta që kërkojnë një caktim të tillë, ndërsa ato rrethana të veçanta duhen specifikuar në hollësi me ato rregulla shtesë.

KREU VI KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME TË GJYKATËS

Neni 13 Kompetenca e administrimit të lëndëve

1. Dhoma e Posaçme, apo secili Kolegj, Nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm sipas kësaj Shtojce kanë kompetenca tjera të përcaktuara me elemente tjera të ligjit në Kosovë përveç atyre të caktuara këtu.

2. Përveç nëse me këtë Shtojcë shprehimisht përcaktohet ndryshe, çdo Kolegj, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm mund të ndërmarrë veprimet në vijim në lidhje me çdo rast apo procedurë që mbahet apo kryhet nga ai Kolegj, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm:

2.1. kur ekzistojnë rrethana detyruese që arsyetojnë veprimin e tillë: zgjat afatin e zbatimit të një Vendimi, edhe nëse kërkesa për zgjatje parashtrohet pas kalimit të afatit të zbatimit;

2.2. shtyn për më vonë apo cakton për më herët një seancë dëgjimore;

2.3. obligon palën apo përfaqësuesin ligjor të palës që të marrë pjesë në gjykim;

2.4. gjatë seancës dëgjimore, merr provat përmes telefonit apo përmes metodave tjera të komunikimit të drejtpërdrejtë verbal;

2.5. udhëzon që pjesët e një procedure të trajtohen si procedura të veçanta, apo bashkon procedurat e ndara;

2.6. kur ekzistojnë rrethana detyruese që arsyetojnë veprimin e tillë: pezullon lëndën apo procedurën apo zbatimin e një aktvendimi apo aktgjykimi, ose në përgjithësi, apo deri në një kohë apo ngjarje të caktuara;

2.7. gjykon më shumë se një kërkesë në të njëjtën kohë;

2.8. urdhëron gjykim të ndarë mbi cilëndo lëndë;

2.9. vendos renditjen e gjykimit të lëndëve;

2.10. përjashton lëndën nga trajtimi;

2.11. hedh poshtë apo shtyn kërkesën pasi të ketë marrë aktvendim mbi një lëndë preliminare;

2.12. urdhëron palën të parashtrorë dhe zbatojë vlerësimin e shpenzimeve; si dhe

2.13. merr çfarëdo aktvendimi apo bën hapa të tjerë me qëllim të administrimit të lëndës dhe avancimit të synimit mbizotërues.

3. Kur Kolegji, Nën-Kolegji apo Gjyqtari i Vetëm nxjerr aktvendim, ai mundet :

3.1. të nxjerrë një aktvendim të tillë që i nënshtrohet kushteve sipas nevojës apo përshtatshmërisë në rrethana të caktuara, duke përfshirë edhe kushtin e pagesës së ndonjë shume të parave në gjykatë; si dhe

3.2. të theksojë pasojat e dështimit në zbatimin e aktvendimit apo cilitdo aspekt të tij.

4. Çdo Kolegj, nën-kolegj apo Gjyqtar i Vetëm mund të urdhërojë palën të paguajë një shumë parash në gjykata nëse ajo palë, pa ndonjë arsye të mirë, ka dështuar të zbatojë aktvendimin apo aktgjykimin. Në ushtrimin e kompetencës së saj sipas këtij paragrafi, Gjykata do të marrë parasysh vlerën e kontestit, shpenzimet që palët kanë bërë deri në atë moment apo mund të bëjnë në të ardhmen, si dhe mundësitë financiare të palëve të përfshira. Kur pala paguan para në gjykatë në zbatim të një urdhri të tillë, paratë e paguara do të shërbejnë si sigurim i shumës që i paguhet apo mund t'i paguhet një pale tjetër nga ajo palë.

Neni 14 Seancat dhe shqyrtimet

1. Datat dhe koha e seancave të Kolegjeve të Specializuara dhe Kolegjit të Apelit do të caktohen nga Kryesuesi i Kolegjit përkatës. Kolegji mund të vendosë të mbajë një apo më shumë seanca në një vend tjetër përveç atij ku Dhoma e Posaçme ka selinë.

2. Gjitha Kolegjet bëjnë shqyrtimin e tyre në seanca të mbyllura. Regjistermbajtësi dhe punëtorët tjerë të gjykatës mund të jenë të pranishëm gjatë shqyrtimeve, por vetëm nëse kjo prani lejohet nga Kryesuesi i Kolegjit.

3. Çdo aktgjykim dhe aktvendim i Kolegjit vendoset me votën afirmative të:

3.1. në rastin e Kolegjit të Specializuar, dy gjyqtarëve; si dhe

3.2. në rastin e Kolegjit të Apelit, tre gjyqtarëve.

4. Nxjerrja e aktgjyqimeve dhe aktvendimeve nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm bëhet në përputhje me paragrafin 2 përkatësisht paragrafin 3, të nenit 11 të kësaj Shtojce.

Neni 15 Referimi i kërkesave në gjykata tjera

Paragrafi 4. i nenit 4 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme rregullon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me referimin e kërkesave ose çështjeve tjera tek gjykatat tjera.

Neni 16 Tërheqja e lëndëve që presin zgjidhje në ndonjë gjykatë tjetër në Kosovë

1. Nëse Dhoma e Posaçme vendos që një gjykatë tjetër në Kosovë është duke ushtruar apo duke provuar të ushtrojë kompetencë mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast që ka të bëjë me kompetencën lëndore të Dhomës së Posaçme, duke shkelur paragrafin 5. të nenit 4 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme, me kërkesë të një personi apo me iniciativë vetanake, i urdhëron gjykatës në fjalë t'i bartë kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin tek Dhoma e Posaçme, në pajtim me paragrafin 7. të nenit 4 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme.

2. Urdhri i nxjerrë nga Dhoma e Posaçme sipas paragrafit 7., neni 4, i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, është përfundimtar dhe detyrues për gjykatën në fjalë dhe gjitha palët e procedurës në fjalë. Urdhri i dërgohet gjykatës në fjalë, palëve në procedurë dhe Agjencisë. Urdhri obligon gjykatën në fjalë t'i bartë menjëherë Dhomës së Posaçme dosjen complete të lëndës, që përfshin mes tjerash të gjithë urdhrat, procesverbalin, deklaratat dhe dokumentet e parashtruara lidhur me kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin.

3. Kërkesa, lënda, procedura apo rasti i cili i nënshtrohet një urdhri të tillë shënohet në regjistrin e Dhomës së Posaçme. Kolegji i Specializuar në fjalë është i autorizuar që ose ta iniciojë rastin nga fillimi (*de novo*) ose të vazhdojë procedurën në pajtim me këtë Shtojcë. Kur vendos të vazhdojë procedurën në pajtim me këtë Shtojcë, Kolegji i Specializuar në fjalë është i autorizuar të ndërmarrë çdo veprim, si dhe të nxjerrë çdo lloj urdhri, sipas nevojës apo përshtatshmërisë, për të korrigjuar parregullsitë substanciale apo procedurale që mund të kenë ndodhur në gjykatën që ka bartur lëndën para datës së bartjes, si dhe të sigurojë zgjidhjen e drejtë dhe të ligjshme të kërkesës, lëndës, rastit apo procedurës, në pajtim me Ligjin mbi Dhomën e Posaçme dhe këtë Shtojcë.

KREU VII DORËZIMI

Neni 17 Adresa e dorëzimit

1. Parashtruesi, në kërkesën apo ankesën e tij, parashtron emrin dhe adresën e një personi në Kosovë i cili shërben si agjent i autorizuar i Parashtruesit, për qëllimin e dorëzimit të dokumenteve. Nëse Parashtruesi është person fizik banues në Kosovë, ai/ajo mund të shërbejë si agjent/e për vetveten.
2. Parashtruesi duhet të shkruajë, në kërkesën apo ankesën e tij, edhe emrin e secilit person që identifikohet shprehimisht si Palë Kundërshtare. Parashtruesi bën përpjekje të arsyeshme dhe të vëmendshme për të vërtetuar dhe për të ofruar adresën më të fundit të njohur të secilit person të tillë, si dhe për ta ofruar atë informatë në kërkesën apo ankesën e tij.
3. Çdo person që parashtron përgjigje, apo që ndryshe kërkon të marrë pjesë si palë në procedurë në Dhomën e Posaçme ofron emrin dhe adresën e një personi në Kosovë i cili shërben si agjent i autorizuar i asaj Pale Kundërshtare apo person për qëllimet e dorëzimit. Nëse Pala Kundërshtuese është person fizik që banon në Kosovë, ai/ajo mund të shërbejë si agjent/e e vetvetes.
4. Pala mund të pajtohet që dorëzimi i parashtrësive, njoftimeve dhe aktvendimeve të bëhet me telefaks ose me ndonjë mjet tjetër elektronik. Në raste të tilla pala ia dorëzon Dhomës së Posaçme të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e dorëzimit me telefaks ose me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit.

Neni 18 Kryerja e dorëzimit

1. Në rastet kur sipas kësaj Shtojce kërkohet që dokumenti t'i dërgohet një pale, Regjistër mbajtësi – ose pala që parashtron dokumentin – duhet të kujdeset që dokumenti të dërgohet në adresën e dorëzimit të asaj pale, ose me anë të postës, duke i dërguar një kopje të regjistruar bashkë me një formular për konfirmimin e pranimit të dërgesës ose duke ia dërguar personalisht kopjen me një vërtetim për pranimin e saj.
2. Në rastin kur pala është pajtuar, sipas paragrafit 4. të nenit 17 të kësaj Shtojce, që dorëzimi mund të kryhet me telefaks ose me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit, çfarëdo dokumenti procedural, pos aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, mund të dorëzohet duke përcjellë një kopje të dokumentit me mjetet e tilla. Në rastet kur për arsye teknike ose për shkak të natyrës apo gjatësisë së dokumentit transmetimi i tillë është i pamundur ose jopraktik, palës i dërgohet dokumenti në pajtim me procedurat e përcaktuara me paragrafin 1. të nenit 18 të kësaj Shtojce, derisa njoftimi për atë dorëzim i ofrohet palës në fjalë me telefaks ose me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit.
3. Konsiderohet se dorëzimi është kryer:
 - 3.1. Kur kopja e një dokumenti është dërguar me postë të regjistruar në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të kësaj Shtojce, në ditën kur marrësi ka bërë të ditur pranimin ose, nëse i adresuari ka refuzuar ta pranojë dokumentin apo ta firmosë pranimin në ditën e pestë pas postimit të letrës së regjistruar në zyrën postare të vendit ku e ka selinë Dhoma e Posaçme;
 - 3.2. kur dokumenti dorëzohet personalisht në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, në ditën në të cilën marrësi e ka konfirmuar pranimin e dokumentit. Nëse marrësi ka refuzuar që ta pranojë, apo shmang pranimin e dokumentit, ose nëse marrësi ka refuzuar apo mundohet t'i shmanget nënshkrimit të pranimit nga ai, data e dorëzimit do të jetë data kur është tentuar apo është bërë dorëzimi. Në atë rast, personi që kryen dorëzimin e dokumentit do të përgatisë një vërtetim të dorëzimit të tentuar, duke përkrahur kohën, datën dhe vendin e tentimit të dorëzimit, si dhe duke përkrahur faktet që vërtetojnë që marrësi ka refuzuar apo ka shmangur dorëzimin dhe/ose nënshkrimin e pranimit. Personi që kryen dorëzimin i kthen atë vërtetim të tentimit të dorëzimit Zyres së Regjistrimit;
 - 3.3. kur dokumenti dërgohet me anë të telefaksit ose me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, në ditën kur dorëzimi është bërë me sukses dhe është dokumentuar, ose kur dorëzim ka qenë i pasuksesshëm për shkak të gabimit të qëllimshëm të marrësit në ditën kur është bërë përpjekja për dorëzim.
4. Pasi të jetë kryer dorëzimi me sukses i kërkesës fillestare, kolegji apo nën-kolegji mund të kërkojë nga pala dërgimin

e parashtrësive dhe dokumenteve shpesh të pala tjetër pa ndihmën e gjykatës. Përveç dëshmisë së dorëzimit, pala e cila dorëzon duhet gjithnjë t'ia parashtrorë gjykatës kopjet e çdo parashtrëse apo dokumenti që i është dërguar palës tjetër pa ndihmën e gjykatës.

5. Në rastet kur identiteti dhe/ose adresa specifike e një pale apo personi të caktuar nuk mund të vërtetohet përfundimisht, edhe pas përpjekjeve të kujdesshme e të arsyeshme, Gjykata lejon dorëzimin konstruktiv me ato mjete që mund të konsiderohen të arsyeshme në bazë të rrethanave. Mjetet e tilla mund të jenë dorëzimi me anë të publikimit, apo dorëzimi tek ndonjë i afërm i njohur apo tek një partner pune.

Neni 19 **Ndihma juridike ndërkombëtare**

1. Për qëllimet e kësaj pjese, termi "Ndihma Juridike Ndërkombëtare" do të thotë ndihma në lidhje me procedurat ligjore e cila ofrohet nga autoritetet e Kosovës për autoritetet e huaja, ose e cila ofrohet nga autoritetet e huaja për autoritetet e Kosovës.

2. Kërkesa nga Dhoma e Posaçme – ose nga një gjykatë e Kosovës së cilës i është referuar kërkesa, lënda, procedura apo rasti nga Dhoma e Posaçme – për ndihmë juridike ndërkombëtare në lidhje me çështjet që janë në kompetencën primare të Dhomës së Posaçme, i nënshtrohet udhëzimeve vijuese:

2.1. kërkesa i dërgohet me shkrim Ministrit të Drejtësisë, duke përcaktuar qartë natyrën e kërkesës, identitetin e autoriteteve të huaja në fjalë, si dhe kohën deri kur kërkohet përgjigjja;

2.2. Ministri i Drejtësisë ia dërgon kërkesën, përmes kanaleve diplomatike zyrtare, autoriteteve të huaja përkatëse jashtë Kosovës; dhe

2.3. Ministri i Drejtësisë ia transmeton gjitha përgjigjet e marra në lidhje me atë kërkesë Dhomës së Posaçme apo gjykatës në fjalë.

3. Kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare nga një gjykatë jashtë Kosovës për çështje të cilat janë nën kompetencën parësore të Dhomës së Posaçme kryhen si vijon:

3.1. Kërkesa bëhet me shkrim, duke saktësuar qartazi natyrën e kërkesës dhe kohën deri kur kërkohet përgjigjja dhe ajo duhet të përfshijë premtimin se materialet e kërkuara do të përdoren vetëm për qëllimet e përmendura në kërkesë;

3.2. Kërkesa i dorëzohet Ministrit të Drejtësisë, i cili pastaj ia dërgon kërkesën Regjistër mbajtësit të Dhomës së Posaçme. Kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, të cilën e merr drejtpërdrejt ndonjë gjykatë në Kosovë nga një autoritet i huaj i kthehet menjëherë atij autoriteti të huaj, bashkë me një letër që këshillon dërguesin që kërkesa duhet dorëzuar tek Ministri i Drejtësisë;

3.3. Nëse kërkesa ka të bëjë me një kërkesë që Dhoma e Posaçme ia ka referuar një gjykate tjetër në Kosovë, Regjistër mbajtësi do t'ia dërgojë kërkesën asaj gjykate për të ndërmarrë masa dhe

3.4. Përgjigjja ndaj kërkesës së tillë dorëzohet nga Dhoma e Posaçme apo gjykata përkatëse tek Regjistër mbajtësi, i cili pastaj ia dorëzon menjëherë atë përgjigje Ministrit të Drejtësisë, ndërsa Ministri i Drejtësisë dërgon pastaj përgjigjen, përmes kanaleve zyrtare autoriteteve kërkuese të huaja.

KREU VIII **PERIUDHAT DHE AFATET KOHORE**

Neni 20 **Llogaritja e periudhave kohore**

1. Periudhat e përcaktuara me Ligjin mbi Dhomën e Posaçme, apo me këtë Shtojcë, llogariten si vijon:

1.1. kur periudha kohore llogaritet nga momenti kur ndodh një ngjarje e caktuar, periudha kohore fillon të llogaritet në mesnatën e ditës kur ndodh ajo ngjarje;

1.2. përveç nëse periudha përkatëse është e përcaktuar shprehimisht me ditë pune, periudha kohore

përfshin gjitha ditët kalendarike.

2. Në qoftë se periudha do të përfundojë në ditën e shtunë, të diel apo në datën e ndonjë feste zyrtare, ajo zgjatet deri në fund të ditës së parë të ardhshme të punës.

Neni 21 **Kalimi i periudhave kohore**

1. Pa paragjykuar përgjegjësitë e veta për të trajtuar çështjet që i parashtrihen në mënyrë të shpejtë, Dhoma e Posaçme, në raste të veçanta dhe kur është në interesin e drejtësisë, mund të vazhdojë afatin e paraparë me ligj apo me këtë Shtojcë, nëse me arsye konstaton se nuk është praktike për palën apo Dhomën e Posaçme që të zgjidhin çështjen në fjalë brenda afatit kohor të paraparë me ligj apo këtë Shtojcë.

2. Nëse pala kërkon zgjatjen e afatit kohor, ajo palë dorëzon një kërkesë për zgjatje të afatit para kalimit të afatit përkatës kohor. Kryesuesi i Kolegjit mund të miratojë zgjatjen nëse kërkesa parashtron rrethanat dhe arsyet të cilat Kryesuesi i kolegjit i konsideron të mjaftueshme për të lejuar zgjatjen, si dhe nëse Kryesuesi i Kolegjit përcakton që asnjë palë nuk i nënshtrohet ndonjë paragjykimi serioz me atë zgjatje.

3. Paka parashtron kërkesën për zgjatje posa të bëhet e vetëdijshme për rrethanat dhe arsyet të cilat ajo palë beson që arsyetojnë zgjatjen. Në asnjë rast, kërkesa nuk mund të parashtrihet pas kalimit të afatit kohor së përcaktuar. Njëkohësisht me parashtrimin e kërkesës, pala i dorëzon gjitha palëve tjera një kopje të asaj kërkesë:

4. Kryesuesi i Kolegjit mund të miratojë zgjatjen vetëm për aq kohë për sa kërkojnë rrethanat e paraqitura me kërkesë.

KREU IX **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 22 **Procedurat gjyqësore**

Procedurat pranë Dhomës së Posaçme përbëhen nga procedurat me shkrim dhe procedurat verbale.

Neni 23 **Obligimet e palëve në procedurë**

1. Palët, në parashtrirat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës. Dhoma e Posaçme sipas detyrës zyrtare bën hetimin e fakteve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

2. Dhoma e Posaçme duhet t'i inkurajojë palët që të arrijnë zgjidhje me negociata para dhe gjatë cilësdo procedurë.

3. Në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore, palët veprojnë në mënyrë të sinqertë.

4. Secila palë, në parashtrirat e saj me shkrim, duhet të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj.

5. Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Neni 24 **Përfaqësimi pranë Dhomës së Posaçme**

1. Secili Parashtrues dhe Palë Kundërshtare përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo odës së avokatëve.

2. Pa marrë parasysh dispozitën më lart, personat fizikë mund të lejohen të përfaqësojnë vetveten, përveç nëse Kryesuesi i Kolegjit nxjerr një urdhër sipas paragrafit 3 të këtij neni.

3. Me kërkesë të cilësdo palë apo me iniciativën e saj, Kryesuesi i Kolegjit mund të urdhërojë që një person fizik të përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo odës së avokatëve, nëse Kryesuesi i Kolegjit konstaton që një urdhër i tillë është i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të palës, ose për mbarëvajtjen e procedurave, ose përndryshe është në interes të drejtësisë. Kryesuesi i Kolegjit nuk merr vendime të tilla nëse nuk është i bindur se:

3.1. personi i tillë është, brenda arsyes, në gjendje të sigurojë përfaqësuesin ligjor; ose

3.2. ndihma juridike do t'i sigurohet asaj pale për t'i mbuluar shpenzimet e përfaqësimit ligjor. Për këtë arsye Kryesuesi i Kolegjit mund t'i shkruajë çdo personi a organi, duke rekomanduar ofrimin e ndihmës juridike për sigurimin e përfaqësuesit dhe duke kërkuar që ai person ose ai organ të deklarohej nëse mund ta ofrojë atë ndihmë juridike.

4. Avokati që punon për palën duhet t'i parashtrijë Zyrës së Regjistrimit një kopje të autorizimit për përfaqësimin e asaj pale në procedurën pranë Dhomës së Posaçme.

5. Dhoma e Posaçme menjëherë njofton palën e cila nuk përfaqësohet nga avokati për dispozitat e këtij neni.

Neni 25 **Parashtrimi i lutjeve**

1. Origjinali i çdo parashtrise duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues ligjor. Origjinali, bashkë me të gjitha shtojcat e përmendura aty dorëzohen në Zyrën e Regjistrimit, bashkë me katër kopje për Dhomën e Posaçme, si dhe nga një kopje për secilën palë në procedurë. Regjistër mbajtësi menjëherë siguron që secila palë në procedurë të pranojë në dorëzim një kopje të tillë.

2. Pas parashtrimit të dokumentit, Regjistër mbajtësi shënon datën e parashtrimit të origjinalit.

3. Pas parashtrimit të lutjes tek Zyra e Regjistrimit, llogaritja e afateve procedurale të cilat fillojnë si rezultat i parashtrimit fillon në mesnatën e ditës së parashtrimit, sipas nenit 20 të kësaj Shtojce.

4. Nëse pala zgjedh të parashtrijë lutje përmes telefaksit apo mjete tjera elektronike tek Zyra e Regjistrimit, lutja e parashtruar në këtë mënyrë duhet të përmbajë edhe shtojcat tjera siç kërkohet me atë lutje, si dhe:

4.1. Pala parashtruese njëkohësisht duhet t'i dërgojë një kopje të gjithë lutjes, duke përfshirë shtojcat siç kërkohet, përmes të njëjtave mjete, gjitha palëve tjera;

4.2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni duhen zbatuar brenda dhjetë (10) ditëve të ardhshme; si dhe

4.3. Nëse dispozitat e këtij paragrafi 4 zbatohen, data e parashtrimit do të jetë data e transmetimit elektronik apo me telefaks; por me kusht që nëse koha e transmetimit elektronik apo me faks është pas orës 16:00 sipas kohës në Kosovë, data e parashtrimit do të jetë dita e ardhshme e punës.

5. Lutja e parë e një sipërmarrjeje duhet përcjellur nga një dokument i nënshkruar nga personi që i jep autorizimin avokatit të sipërmarrjes për përfaqësim, i cili vërteton që ai person ka autoritetin e ligjshëm për t'i dhënë atë autorizim.

6. Përveç në rastet e përcaktuara në mënyrë të veçantë me paragrafin 7. të këtij neni, çdo person ka të drejtë të pakufizuar të marrë menjëherë kopjet e gjitha lutjeve, dokumenteve, aktgjykimeve dhe aktvendimeve të parashtruara apo të nxjerra në lidhje me çdo kërkesë, lëndë, procedurë apo rast tek Dhoma e Posaçme, apo që i është referuar Dhomës së Posaçme nga një gjykatë tjetër. Dhoma e Posaçme cakton dhe publikon tarifën e kopjimit, e cila bartet nga personi që merr ato kopje; kjo tarifë e kopjimit do të bazohet në numrin e faqeve, si dhe nuk do të jetë më e lartë sesa 0.15 Euro.

7. Duke vepruar në bazë të një kërkesë të arsyetuar të parashtruesit të lutjes apo dokumentit, Dhoma e Posaçme mundet të përcaktojë informata të veçanta në ato lutje apo dokumente si konfidenciale, por asnjëherë me iniciativë vetanake. Çdo kërkesë për trajtim konfidencial të informatave në një lutje apo dokument duhet përcjellë me një arsyetim detyrues me shkrim i cili demonstroi që qasja publike ndaj atyre informatave do t'i shkaktonte dëm serioz palës apo personit që dorëzon informatat e tilla. Kur trajton kërkesën e tillë, Dhoma e Posaçme merr përsipër me kujdes interesin publik të domosdoshëm në krijimin e një procesi të hapur dhe transparent gjyqësor. Dhoma e Posaçme nuk miraton kërkesat e tilla nëse informatat përkatëse janë tanimë të qasshme nga publiku diku tjetër. Nëse Dhoma e Posaçme miraton kërkesën e tillë, ajo siguron që qasja publike kufizohet vetëm për informatat e veçanta përkatëse që konsiderohen të ndjeshme, si dhe Dhoma e Posaçme siguron që dosjet e qasshme në Dhomën e Posaçme të përmbajnë një version të redaktuar të dokumentit apo lutjes përkatëse. Aktgjykimet dhe aktvendimet asnjëherë nuk mund të konsiderohen konfidenciale.

8. Lutjet dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten ose në gjuhën Shqipe ose në gjuhën Serbe dhe duhet të

shoqërohen nga një përkthim në gjuhën Angleze. Shpenzimet e përkthimit i heq pala që dorëzon atë lutje dhe ato dokumente.

9. Një person fizik mund t'i paraqesë kërkesë Kryesuesit të Kolegjit për ndihmë rreth përkthimit në gjuhën Angleze të lutjeve dhe dokumenteve përcjellëse. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet bashkë me parashtresat dhe duhet të përfshijë një pasqyrë financiare të mjeteve të palës dhe çfarëdo dëshmie mbështetëse që pala dëshiron që Kryesuesi të marrë parasysh.

10. Gjyqtari kryesues mund të vendosë që përkthimi i lutjeve dhe i dokumenteve përcjellëse që kërkohen sipas paragrafi 8 i këtij neni të bëhet me shpenzimet e Dhomës së Posaçme, nëse ai apo ajo mendon se ky vendim është i arsyeshëm, duke pasur parasysh mjetet financiare të personit fizik. Nëse Kryesuesi i Kolegjit refuzon një kërkesë të tillë, ai duhet ta njoftojë palën me vendim me shkrim dhe të urdhërojë atë person që t'i sigurojë përkthimet në gjuhën angleze me shpenzimet e tij brenda afatit që përcaktohet në vendim. Nëse përkthimet nuk sigurohen brenda këtij afati, Dhoma e Posaçme urdhëron përkthimin e dokumenteve dhe shpenzimet ia ngarkon personit në fjalë.

Neni 26

Tërheqja, ndryshimi, pranimi dhe marrëveshja

1. Parashtruesi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve të tjera. Vendimi për dhënien e pëlqimit për tërheqje mund të përfshijë urdhërpagesën për shpenzimet e procedurës nga pala që tërhiqet. Vendimi i tillë nuk e ndalon palën nga parashtrimi i sërishëm i kërkesës apo ankesës.

2. Pala mund të ndryshojë parashtresat e saj në çdo kohë para përfundimit të procedurës, me pëlqimin e Kryesuesit të Kolegjit. Kryesuesi i Kolegjit vendos nëse do ta pranojë kërkesën për ndryshime, duke marrë parasysh nëse ndryshimi i tillë është në interes të drejtësisë, si dhe dëmet që mund të shkaktohen ndaj palëve tjera.

3. Pala kundërshtare mund të pranojë në cilëndo fazë të procedurës gjyqësore kërkesën apo ankesën e paraqitur kundër tij, në plotësi apo pjesërisht.

4. Marrëveshja e arritur me anë të negociatave mes palëve gjatë procedurës, si dhe konfirmuar me shkrim, merr formë të prerë dhe të plotfuqishme mbi palët.

KREU X

PROCEDURA ME SHKRIM

Neni 27

Nisja e procedurave

1. Një kërkesë apo ankesë i dorëzohet me shkrim Dhomës së Posaçme.

2. Një kërkesë apo ankesë përmban:

2.1. emrin dhe adresën e parashtruesit(ve).

2.2. emrin dhe adresën e avokatit, nëse ka, që vepron në emër të parashtruesit;

2.3. emrin (emrat) dhe adresën (adresat) e palës kundërshtare, deri në atë masë sa përcaktohet me paragrafin 2. të nenit 17 së kësaj shtojce;

2.4. lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtruesi synon t'i paraqes;

2.5. nëse kërkohet kompensim financiar, paraqitet një listë e dëmeve që përcakton natyrën e humbjes apo dëmit, shumën e parave që pretendohet për çdo lloj humbje apo dëmi, si edhe provat që duhet të paraqiten për mbështetjen të atij lloji të humbjes apo të dëmit, dhe

2.6. nëse kërkohet kompensim jo-financiar, parashtruesi(t) do të saktësojë natyrën e kompensimit të tillë duke marrë parasysh dispozitat e nenit 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Parashtruesi(t) gjithashtu do të

paraqet shumën e kompensimit financiar (të mbështetur me një listë të dëmeve që përcaktohet me nën-paragrafin 2.5. të këtij neni në rast se Dhoma e Posaçme vendos se nuk mund, ose nuk do të caktojë një kompensim të tillë jo-financiar.

Neni 28 **Pranueshmëria e kërkesës/ankesës**

1. Pas pranimit dhe regjistrimit të një kërkesë apo ankese, dhe pas dërgimit të saj në Kolegjin gjegjës të Specializuar, Kolegji i Specializuar vendos nëse kërkesa/ankesa është e pranueshme në mbështetje të nenit 12 të kësaj shtojce,

2. Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse:

2.1. Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme;

2.2. parashtruesi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1. të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme;

2.3. kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2. të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme;

2.4. kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 1. të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme;

2.5. parashtruesi ka paraqitur njoftimin siç përcaktohet me paragrafin 1. ose 2, cilido që zbatohet, të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; si dhe

2.6. kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 25 të kësaj shtojce dhe është në përputhje me dispozitat e nenit 27 të kësaj shtojce.

3. Nëse Kolegji i Specializuar vlerëson se kushtet e përcaktuara me paragrafin 2. të këtij neni nuk janë përmbushur, atëherë ai hedh poshtë kërkesën/ankesën në baza të papranueshmërisë si dhe saktëson në hollësi bazën ligjore për refuzimin e tillë. Nëse kërkesa/ankesa refuzohet vetëm për shkak se nuk i përmbahet nën-paragrafi 2.6. të këtij neni, atëherë Kolegji i Specializuar do t'i lëshojë një urdhër Parashtruesit me të cilin saktësohet afati i arsyeshëm kohor brenda të cilit Parashtruesi mund të korrigjojë gabimet dhe prapë të parashtrojë kërkesën/ankesën.

4. Në çdo kohë, cilado palë kundërshtare mund të paraqes një lutje me shkrim ku pohohet se kërkesa ose ankesa dështon, në bazë të ligjit, të deklarojë pretendimin për të cilën kërkohet caktimi i kompensimit apo i zhdëmtimit. Nëse parashtrohet një lutje e tillë, atëherë Parashtruesi do të ketë katërmbëdhjetë (14) ditë afat për të paraqitur përgjigjen e tij me shkrim. Pastaj, Kolegji i Specializuar do të caktojë seancë dëgjimit me gojë për këtë çështje.

5. Nëse, pas shqyrtimit të argumenteve me shkrim dhe me gojë të palëve, Kolegji i Specializuar vendos që në bazë të ligjit nuk mund të caktohet asnjë zhdëmtim apo kompensim lidhur me kërkesën/ankesën, atëherë ai nxjerrë një Aktgjykim me anë të së cilit refuzohet kërkesa/ankesa në po atë bazë. Nëse Kolegji i Specializuar vendos që kërkesa apo ankesa përmban një pretendim, në bazë të së cilit mund të caktohet kompensimi apo zhdëmtimi në mbështetje të ligjit, atëherë ai nxjerrë një Aktvendim me të cilin hidhet poshtë lutja e palës kundërshtare. Një Aktgjykim apo Aktvendim i tillë mund të apelohe në Kolegjin e Apelit, në pajtim me rregullat që rregullojnë apelimet e tilla.

Neni 29 **Mbrojtja e palës kundërshtare**

1. Pala kundërshtare mund të paraqes mbrojtjen brenda një muaji pasi t'i jetë dorëzuar kërkesa/ankesa. Mbrojtja përmban:

1.1. emrin dhe adresën e palës kundërshtare;

1.2. emrin dhe adresën e për dërgim avokatit, i cili vepron në emër të palës kundërshtare;

1.3. përgjigjen e palës kundërshtare ndaj fakteve të pretenduara nga parashtruesi;

1.4. kundër-argumentet e palës kundërshtare ndaj argumenteve ligjore të paraqitura nga parashtruesi; si dhe

1.5. përgjigjen e palës kundërshtare ndaj kërkesës për zhdëmtim dhe/ose kompensim të pretenduar nga parashtruesi.

2. Afati kohor prej një (1) muaji, i përcaktuar me paragrafin 1. të këtij neni, mund të zgjatet me anë të një Aktvendimi të nxjerrë nga Kolegji i Specializuar ose, nëse mund të zbatohet, edhe nga një Gjyqtar i vetëm apo një nën-kolegj, pas dorëzimit të kërkesës së arsyetuar nga pala kundërshtare.

Neni 30

Përgjigja e parashtruesit dhe kundërpërgjigja e palës kundërshtare.

1. Pas dorëzimit të mbrojtjes nga pala kundërshtare, Parashtruesi ka pesëmbëdhjetë (15) ditë afat kohor për të paraqitur përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes.

2. Pas dorëzimit të përgjigjes nga parashtruesi, Pala kundërshtare ka pesëmbëdhjetë (15) ditë afat kohor për të paraqitur kundërpërgjigjen e saj ndaj përgjigjes.

Neni 31

Kundërkërkesa

1. Pala kundërshtare duhet të paraqesë çfarëdo kundërkërkesë që mund të ketë brenda afatit të njëjtë kohor që lejohet për paraqitjen e mbrojtjes së saj.

2. Kundërkërkesat do t'iu nënshtrohen po të njëjtave kushteve të pranueshmërisë që përcaktohen me paragrafin 2. të nenit 28 të kësaj shtojce lidhur me kërkesat/ankesat. Parashtruesi, kundër të cilit është paraqitur një kundërkërkesë, mund të dorëzojë një kërkesë në Kolegjin e Specializuar për të ndarë kundërkërkesën nga procedurat mbi bazën e asaj që faktet e kontestit ndërmjet palëve, në lidhje me kërkesën/ankesën e parashtruesit, nuk kanë lidhje materiale me kundërkërkesën. Kolegji i Specializuar lejon një kërkesë të tillë nëse përcakton se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend. Nëse ndahet kundërkërkesa, atëherë ajo do të futet në regjistër si një lëndë e re dhe e veçantë, si dhe:

2.1. kundërkërkesë do të konsiderohet kërkesa/ankesa në atë lëndë të re;

2.2. pala kundërshtare në lëndën e mëparshme do të jetë Parashtruesi në lëndën e re, si dhe

2.3. parashtruesi në lëndën e mëparshme do të jetë Pala kundërshtare në lëndën e re.

Neni 32

Përfundimi i procedurave me shkrim

1. Procedurat me shkrim do të përfundojnë:

1.1. nëse pala kundërshtare nuk ka paraqitur me kohë mbrojtjen, gjegjësisht deri në mesnatën e datës kur mbrojtja e tillë duhet të dorëzohet;

1.2. nëse pala kundërshtare me kohë ka paraqitur mbrojtjen, por Parashtruesi nuk ka paraqitur me kohë përgjigjen ndaj mbrojtjes, gjegjësisht deri në mesnatën e datës kur mbrojtja e tillë duhet të dorëzohet;

1.3. nëse Parashtruesi me kohë ka paraqitur përgjigjen ndaj mbrojtjes, gjegjësisht deri në mesnatën e datës kur kundërpërgjigja e palës kundërshtare duhet dorëzuar.

Neni 33

Udhëzimet procedurale për dëgjimin e kërkesave

1. Kurdoherë gjatë procedurave, Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë bashkimin e dy apo më shumë kërkesave/ankesave që kanë të bëjnë me të njëjtën çështje për qëllim të procedurave me shkrim apo me gojë ose të Aktgjykimit. Para nxjerrjes së një Aktgjykimi për të gjitha kërkesat/ankesat që do të bashkohen, mund të ndahet çfarëdo kërkesë/ankesë për të cilën nuk është nxjerrë një Aktgjykim.

2. Kurdoherë, Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë gjykimin e një apo më shumë çështjeve para gjykitit të çfarëdo çështjeje tjetër, po që se Dhoma e Posaçme vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend, do t'i shërbehet efikasitetit gjyqësor ose edhe zgjidhjes së shpejtë të procedurave.

3. Dhoma e Posaçme mund t'i ftojë palët në një dëgjim verbal në çdo kohë, me qëllim të nxjerrjes së udhëzimeve dhe/ose orarit për zhvillimin e mëtutjeshëm të procedurave.

Neni 34

Raporti paraprak i gjyqtarit të vetëm

1. Nëse një Kolegji i Specializuar ia ka deleguar procedurat një Gjyqtari të vetëm, në mbështetje të nenit 11 të kësaj shtojce, atëherë Kolegji i Specializuar cakton datën kur gjyqtari duhet t'ia paraqesë një raport paraprak Kolegjit të Specializuar. Kjo datë do të jetë sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të procedurave me shkrim.

2. Raporti paraprak përmban përmbledhjen e gjyqtarit të vetëm për lëndën, faktet materiale për të cilat ka pajtim apo për të cilat duket se nuk kundërshtohen, faktet materiale dhe çështjet ligjore që kontestohen, statusin procedural të lëndës dhe orarin e propozuar për procedimin e mëtutjeshëm të lëndës.

3. Në bazë të raportit paraprak, Kolegji i Specializuar mund të vendosë që të heqë dorë nga mbledhja e provave nëse vlerëson që nuk ka ndonjë kontest të mirëfilltë mes fakteve materiale e që janë domosdoshme për vendosur mbi atë lëndë apo çështje në fjalë.

4. Para nxjerrjes së një urdhri në mbështetje të paragrafit 3. të këtij neni, Kolegji i Specializuar njofton palët se është duke shqyrtuar mundësinë e nxjerrjes së një urdhri të tillë dhe fton palët që t'ia paraqesin parashtrësit dhe argumentet mbi atë nëse një urdhër i tillë duhet marrë. Kolegji i Specializuar mund të nxjerrë një urdhër të tillë vetëm nëse vendos që të gjitha palët kanë pasur një mundësi të arsyeshme për t'i paraqitur parashtrësit dhe argumentet e tilla.

5. Nëse vendimi për të hequr dorë nga mbledhja e provave është marrë në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, atëherë dispozitat e nenit 11 të kësaj shtojce nuk do të zbatohen për lëndën apo rastin që i nënshtrohen një urdhri të tillë.

KREU XI

DËSHMITË DHE SEANCAT DËGJIMORE

Neni 35

Bartja e kompetencës për mbledhjen e provave te nën-kolegjet apo gjyqtarët

1. Kryesuesi i Kolegjit mund të bart mbledhjen e provave te gjyqtari i vetëm apo nën-kolegji.

2. Mbledhja e provave nga një Kolegji i Specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm bëhet në pajtim me këtë shtojcë.

Neni 36

Rregullat e përgjithshme mbi provat

1. Një palë mund t'i paraqet prova duke:

1.1. paraqitur, ose duke kërkuar nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës që të urdhërojë paraqitjen, origjinalin e dokumentit që është i rëndësishëm për një apo më shumë çështje ligjore, ose për pretendimet faktike në lëndën apo procedurat; gjyqtari(ët) mund të pranojë një kopje të dokumentit të tillë në pritje të atij autentik por vetëm nëse pala parashtruese siguron një shpjegim të pranueshëm se përse nuk mund të sigurohet ai autentik;

1.2. paraqitur, ose duke kërkuar nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës që të ftojë dëshmitarët për të siguruar dëshmi faktike apo çfarëdo dëshmi tjetër gjatë procedurave verbale; megjithatë, nëse pala ka për qëllim paraqitjen e një dëshmitari të tillë, atëherë ajo palë duhet t'i sigurojë gjyqtarit(ve) dhe palëve tjera emrin dhe adresën e secilit dëshmitarët së paku pesë (5) ditë para ditës kur dëshmitari paraqet dëshminë;

1.3. paraqitur ekspertë të cilët sigurojnë raporte ekspertësh dhe dëshmi ekspertësh gjatë procedurave verbale; megjithatë, pala që ka për qëllim paraqitjen e një eksperti të tillë duhet t'i sigurojë gjyqtarit(ve) dhe palëve tjera emrin dhe adresën e secilit ekspert si dhe përshkrimin e fushës së tij/saj të ekspertizës, së paku pesë (5) ditë para ditës kur dëshmitari paraqet dëshminë;

1.4. paraqitur një mjet fizik që është i rëndësishëm për çështjen faktike të lëndës apo procedurës;

1.5. paraqitur traktatet, shkrimet dhe materialet e tjera me shkrim, autorët e të cilave janë persona të cilët kanë ekspertizë apo njohuri të veçantë lidhur me lëndën që është thelbësore për çështjen ligjore apo faktike të lëndës apo procedurës;

1.6. kërkuar nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës që të urdhërojë shikimin e terrenit apo inspektimin e një objekti; kjo kërkesë shoqërohet nga një shpjegim ku tregohen faktet që duhet konfirmuar nëpërmjet shikimit apo inspektimit të tillë; dhe

1.7. paraqitur çfarëdo dëshmi tjetër që lejohet nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës, po që se gjyqtari(ët) së pari përcakton se pala ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme se dëshmia e tillë pritet të jetë e rëndësishme për çështjen ligjore apo faktike të lëndës apo procedurës.

2. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do t'i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Kur prova e paraqitur nga njëra palë është në formën e dëshmisë ose dëshmisë nën betim, atëherë secila palë tjetër ka mundësinë për të marrë në pyetje personin që ka dhënë dëshminë nën betim apo që ofron një dëshmi të tillë, ose nëpërmjet dëshmisë në gjykatë, ose nëpërmjet dhënies së dëshmisë nën betim që është e xhiruar në video/audio shirit dhe që është e transkriptuar.

3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

4. Gjyqtari(ët) ka për detyrë që, në mënyrë të pavarur, të vlerësojë besueshmërinë e ndonjë dhe të gjitha provave (të dokumentuara, fizike apo dëshmuese) që paraqiten apo dorëzohen në lëndë apo procedurë.

Neni 37

Urdhrat që detyrojnë paraqitjen e dëshmitarëve

1. Pas paraqitjes së lutjes nga një palë, dhe pas paraqitjes së arsyeve të mira në atë lutje, gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës urdhëron paraqitjen e një personi në gjykatë, ose dhënien e dëshmisë me qëllim të marrjes së dëshmisë dhe/ose paraqitjes së dokumenteve (duke përfshirë dokumentet në formë elektronike) ose çfarëdo mjeti tjetër që është i rëndësishëm për lëndën dhe procedurën.

2. Lutja e tillë përmban informatat si në vijim:

2.1. emrin dhe adresën e fundit të njohur të personit dhe çfarëdo informate tjetër që disponon parashtruesi e që mund ndihmon në identifikimin e vendndodhjes së personit;

2.2. nëse personi do të dëshmojë, atëherë duhet të paraqitet një tregues i përgjithshëm i fakteve materiale për të cilat besohet se personi ka njohuri;

2.3. nëse besohet se personi ka dokumente të rëndësishme (duke përfshirë dokumentet në formë elektronike) apo çfarëdo mjeti tjetër në posedim të tij/saj, atëherë duhet të ketë një përshkrim të përgjithshëm të atyre dokumenteve; si dhe

2.4. një zotim nga pala që paraqet lutjen e tillë për pagimin e shpenzimeve të arsyeshme të personit, siç përcaktohet në përputhje me nenin 41 të kësaj shtojce; nëse pala e tillë përfundimisht fiton në lëndë apo procedurë, atëherë gjyqtari(ët) mund të urdhërojë palën tjetër që t'i paguajë këto shpenzime.

3. Gjyqtari(ët) mund, pas shqyrtimit të lutjes, të vlerësojë se pala që ka paraqitur lutjen nuk ka treguar arsye të mjaftueshme për të nxjerrë urdhrin.

4. Nëse gjyqtari(ët) vendos që të nxjerrë urdhrin, atëherë ose Regjistër mbajtësi, ose pala që ka paraqitur lutjen, udhëzohen për t'ia dorëzuar urdhrin dëshmitarit. Megjithatë, nëse dëshmitari nuk është fizikisht i pranishëm në Kosovë dhe nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë një kërkesë për dorëzimin e urdhrin bëhet në përputhje me paragrafin 2 të nenit 19 të kësaj shtojce.

5. Një dëshmitar, i cili në kohën e dorëzimit të urdhrin është fizikisht i pranishëm në Kosovë, ose i cili ka vendbanim në Kosovë dhe të cilin zyrtarisht dhe me kohë i është dorëzuar urdhri i tillë, do ta ketë detyrim të rreptë për t'iu përmbajtur urdhrin të tillë. Nëse dëshmitari nuk është në gjendje që të paraqitet në kohën e saktësuar në urdhër, atëherë dëshmitari – para kohës së paraqitjes të saktësuar në urdhër – parashtron një kërkesë te gjyqtari(ët) duke shpjeguar përse ai/ajo nuk mund të paraqitet në kohën e saktësuar dhe duhet të saktësojë kohën kur ai/ajo mund të paraqitet. Pas pranimit me kohë të një kërkesë të tillë, gjyqtari(ët) ndryshon urdhrin në përputhje me kërkesën dhe pastaj ai urdhër i dorëzohet dëshmitarit.

6. Nëse një dëshmitar dështon që t'i përmbahet një urdhri, atëherë gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës ia shqipton një gjobë që nuk është më pak se një mijë (1000) Euro dhe jo më shumë se pesë mijë (5000) Euro. Gjyqtari(ët) pastaj nxjerrë urdhrin e dytë që i dorëzohet dëshmitarit. Nëse dëshmitari dështon t'i përmbahet urdhrin të dytë, atëherë gjyqtari(ët) ia shqipton atij një gjobë shtesë në shumë prej pesë mijë (5000) Euro, do të vlerësojë se dëshmitari po e shpërfill gjykatën dhe lëshon një urdhër arrestimi, duke i kërkuar kështu Policisë së Kosovës arrestimin e dëshmitarit dhe sjelljen e tij para gjykatës.

7. Një dëshmitar i cili gjobitet sipas paragrafit 6. të këtij neni mund të kërkojë uljen e gjobës, nëse ai dëshmon që shuma është në shpërpjesëtim me mjetet e tij apo saj.

Neni 38 **Dëshmia**

1. Një person i cili do të paraqet dëshminë nuk do të jetë i pranishëm gjatë çfarëdo parashtrës verbale apo gjatë dhënies së dëshmive apo marrjes në pyetje të cilitdo dëshmitar tjetër, përveçse ai person nuk është palë.

2. Palët kanë të drejtën për të qenë të pranishëm gjatë dhënies së dëshmive dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

3. Në fillim të marrjes në pyetje, Kryesuesi përcakton identitetin e dëshmitarit. Dëshmitari do të njoftohet për pasojat penale për dhënien e dëshmisë së rrejshme dhe nga ai do të kërkohej që të betohet apo të deklarojë solemnisht se dëshmia të cilën e ka dhënë është e vërtetë.

4. Pasi dëshmitari të jep dëshminë e tij/saj, gjyqtari(ët) mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit. Avokatët e palëve mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit nën mbikëqyrjen e gjyqtarit kryesuesi apo të gjyqtarit të deleguar për mbledhjen e provave.

5. Dëshmitari mund të refuzojë të jap dëshmi për:

5.1. deklaratat e bëra nga apo për dëshmitarin gjatë një rrëfimi fetar;

5.2. nëse është mjek, avokat apo praktikues profesional i licencuar i çfarëdo profesioni tjetër ku ruajtja e fshehtësisë lidhur me komunikimin me klientin është thelbësore për kryerjen e mirëfilltë të atij profesioni:

5.2.1. deklaratat e bëra ndaj dëshmitarit nga pacienti/klienti ose nga dëshmitari për pacientin/klientin, me gojë ose me shkrim, por vetëm deri në atë masë sa këto deklarata janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me kryerjen e shërbimeve profesionale nga dëshmitari për pacientin/klientin, dhe

5.2.2. informatat e marra nga dëshmitari për një pacient/klient, nëse informatat e tilla janë marrë për qëllime që drejtpërdrejt lidhet me kryerjen e shërbimeve profesional nga dëshmitari për pacientin/klientin, apo

5.3. informatat që do të implikonin dëshmitarin, bashkëshorten e dëshmitarit, fëmijët apo prindërit e dëshmitarit.

6. Gjyqtari kryesuesi apo gjyqtari i deleguar për mbledhjen e provave njoftojnë njoftojë dëshmitarët për të drejtën e tyre për të refuzuar dhënien e dëshmive që ceken në paragrafin 5. të këtij neni.

7. Para dhënies së dëshmisë, dëshmitari do të bëjë betimin si në vijim: “Unë, _____ solemnisht deklarojë që do ta them të vërtetën, vetëm të vërtetën dhe asgjë pos të vërtetës.”

8. Sekretari i gjykatës do ta mbajë procesverbalin fjalë-për-fjalë për ta pasqyruar saktësisht deklaratën e dëshmitarit. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryesuesi apo gjyqtari përgjegjës për marrjen në pyetje të dëshmitarit dhe nga sekretari i gjykatës.

Neni 39 **Caktimi i ekspertëve të pavarur**

1. Gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës në fjalë mund, me nismë të vet gjyqtarit(ve) apo në bazë të kërkesës së një pale, të caktojë një ekspert të pavarur për të hartuar një raport ekspertësh dhe për të dhënë dëshminë lidhur me çështjet faktike që janë të rëndësishme për lëndën apo procedurën. Urdhri, në bazë të së cilit caktohet eksperti, përkufizon detyrat e ekspertit dhe cakton afatin kohor brenda së cilit eksperti duhet ta hartojë raportin në fjalë.
2. Një person nuk mund të caktohet apo nuk mund të shërbejë si ekspert i pavarur në ndonjë lëndë apo procedurë nëse ai apo ajo:
 - 2.1. në çfarëdo cilësie ka marrë pjesë më herët, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, në lëndën apo procedurat e tilla;
 - 2.2. është angazhuar më herët si punëtor apo kontraktues nga ndonjëra palë;
 - 2.3. ka lidhje gjaku apo martesore me ndonjërin palë, ose në rast se pala është një kompani apo ndonjë entitet tjetër ka lidhje gjaku apo martesore me një person i cili është punëtor, kontraktues apo pronar i cili është anëtar i bordit të një entiteti të tillë apo i cili mban funksione të mëdha drejtuese në këtë entitet;
 - 2.4. ka apo siguron interesa të drejtpërdrejta apo të tërthorta në ndonjë entitet që ka fituar një të drejtë apo interes në një kompani që është palë në procedurë; apo
 - 2.5. ka ndonjë marrëdhënie të identifikueshme, lidhje, pozitë apo interes fitimprurës që, në mënyrë të arsyeshme, mund të pritet të pengojë aftësinë e tij/saj për të kryer detyrat e ekspertit në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale.
3. Eksperti i pavarur, i caktuar nga gjykata, merr një kopje të urdhrit së bashku me të gjitha provat në posedim të gjykatës e që janë thelbësore për kryerjen e detyrave të ekspertit. Eksperti është nën mbikëqyrjen e gjyqtarit(ve) të lëndës apo procedurës.
4. Gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës kërkon nga palët që të paguajnë një kapar në Zyrën e regjistrimit e Dhomës së Posaçme, në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar tarifat e përlllogaritura dhe shpenzimet lidhur me hartimin e raportit nga eksperti.
5. Ekspertët e caktuar nga gjykata paraqesin mendimin e tyre vetëm për ato çështje faktike që shprehimisht iu janë referuar atyre me anë të urdhrit gjegjës.
6. Eksperti i caktuar nga gjykata ai paraqet kopjet e raportit të tij/saj drejtpërdrejt gjyqtarit(ve) gjegjës dhe Zyrës së Regjistrimit që menjëherë ia dorëzon palëve kopjet e këtij raporti.
7. Gjyqtari(ët) do të kërkojë që eksperti të merret në pyetje gjatë një seance dëgjimore. Gjyqtari(ët) mund t'i parashtojë pyetje ekspertit. Pyetjet mund të parashtrihen nga avokatët e palëve, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit kryesues.
8. Para caktimit të tij/saj, nga eksperti do të kërkohet që të betohet si më poshtë:

“Unë, _____, solemnisht deklaroj se do të kryej detyrën me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme detyrën time; se unë nuk kam kurrfarë marrëdhënie, lidhje, pozite apo interesi fitimprurës që do pengonte aftësitë e mia për të kryer detyrat në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale. Unë do t'ia ofroj Gjykatës kopjet e të gjitha provave në bazë të së cilave unë do të mbështes mendimin tim; se unë do të mbështes mendimin tim vetëm mbi ato fakte të cilat unë besoj se janë të vërteta; dhe se unë me nder e besnikëri do ta mbroj mendimin të cilin do t'ia paraqes Gjykatës.”
9. Përzgjedhja e ekspertit nga gjyqtari(ët) nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për prokurim publik të Kosovës. Megjithatë, gjyqtari(ët) do të përzgjedhë – nga ekspertët në dispozicion të cilët gëzojnë të drejtën e përzgjedhjes sipas paragrafit 2 të këtij neni – ekspertin më të kualifikuar për të dhënë mendimin në fjalë. Gjyqtari(ët) po ashtu do të sigurojë se çfarëdo aranzhimi lidhur me pagesën e tarifave dhe shpenzimeve do të jetë i arsyeshëm.

Neni 40**Kundërshtimet ndaj dëshmitarëve dhe ekspertëve**

1. Cilado palë mund të kundërshtojë të drejtën dhe kompetencën profesionale të ndonjë dëshmitari apo eksperti të propozuar, duke kërkuar nga gjyqtari(ët) të gjykojë për çështjen në fjalë apo të vazhdojë me ndalimin e dëshmitarit apo ekspertit nga dhënia e dëshmisë, ose plotësisht, ose pjesërisht për çështjen e veçantë.

2. Cilado palë po ashtu mund të kundërshtojë ndonjë pjesë të dëshmisë apo prove tjetër që paraqitet nga një dëshmitar apo ekspert, në bazë të asaj që dëshmia apo prova nuk është e rëndësishme apo përkatëse, ose që dëshmitari apo eksperti nuk është kompetent paraqitjen e një dëshmie të tillë apo për të ofruar prova të tilla. Kundërshtimi i tillë bëhet ose para, ose pas dhënies së dëshmisë apo paraqitjes së provës. Nëse kundërshtimi paraqitet para dhënies së dëshmisë në fjalë, apo paraqitjes së provës, atëherë gjyqtari(ët) mund – nëse vlerëson që kundërshtimi është i bazuar – të ndalojë dëshmitarin apo ekspertin nga dhënia e dëshmisë apo paraqitja e provave në fjalë. Nëse kundërshtimi paraqitet pas dhënies së dëshmisë apo paraqitjes së provave në fjalë, atëherë gjyqtari(ët) mund – nëse vlerëson që kundërshtimi është i bazuar – të urdhërojë mospërfilljen dhe përjashtimin e dëshmisë dhe/apo provave nga regjistri.

3. Pala që paraqet kundërshtimin duhet të deklarojë arsyet e saj për kundërshtimin e tillë. Secila palë tjetër ka mundësinë për ta mbështetur apo për ta kundërshtuar dhe për të ofruar arsyet për qëndrimin e tyre; megjithatë, me kusht që kundërshtimi paraqitet gjatë zhvillimit të dëgjimit verbal dhe që kjo mundësi t'i jepet vetëm palëve që janë të pranishme gjatë seancës dëgjimore.

4. Kundërshtimi ndaj dëshmitarit apo ekspertit duhet të paraqitet menjëherë.

5. Kurdoherë gjyqtari(ët) mund të kërkojë nga palët të paraqesin parashtresa me shkrim ndaj një kundërshtimi që është paraqitur. Nëse gjyqtari(ët) merr një veprim të tillë, atëherë palët kanë jo më shumë se pesë (5) ditë pune për të paraqitur parashtresa të tilla. Kundërshtimi mbetet i vërtetuar gjersa gjyqtari(ët) nuk nxjerr një Aktvendim lidhur me kundërshtimin, dhe Aktvendimi i tillë merret brenda pesë (5) ditëve pune pas afatit për paraqitjen e parashtresave me shkrim nga palët.

6. Përveç siç është përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 38 të kësaj shtojce, nëse një person paraqitet apo sillet në gjykatë në cilësinë e dëshmitarit apo ekspertit, dhe nëse ky person refuzon të dëshmojë apo paraqet prova ose t'i përgjigjet pyetjes edhe pse urdhërohet nga gjykata, ose nëse refuzon të jep betimin apo deklaratën solemne edhe pse urdhërohet nga gjykata, atëherë gjyqtari(ët) e lëndës apo procedurës në fjalë ia shqipton personit gjobën në shumë prej jo më pak se njëmijë euro (1000 €) dhe jo më shumë se pesëmijë euro (5000 €), do të vlerësojë se dëshmitari po e shpërfill gjykatën dhe do të lëshojë një urdhër arrestimi, duke i kërkuar kështu organeve të zbatimit të ligjit arrestimin e personit derisa ky person të pajtohet me respektimin dhe në të vërtetë respekton urdhrin gjegjës. Megjithatë, ky paragraf 6 nuk zbatohet kur ka bazë të arsyeshme për të konkluduar se detyrimi i personit në fjalë për të dhënë dëshminë e kërkuar do të përbënte shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese të dëshmitarit.

Neni 41**Kompensimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve**

1. Dëshmitarët dhe ekspertët kanë të drejtën e kompensimit për shpenzimet e tyre të udhëtimit dhe për shpenzimet e tjera. Gjyqtari(ët) në lëndën apo procedurën gjegjëse autorizon Zyrën e Regjistrimit që bëjë parapagimin e një dëshmitari apo eksperti për shpenzimet e tilla.

2. Dëshmitarët kanë të drejtën e kompensimit për humbjet e dokumentuara të fitimit dhe ekspertët kanë të drejtën e tarifës së arsyeshme për shërbimet e tyre. Kompensimi apo tarifa e tillë paguhet vetëm pasi që gjyqtari(ët) i procedurës apo lëndës t'ia ketë konfirmuar Zyrës së Regjistrimit se dëshmitari apo eksperti ka kryer obligimet e tij/saj ndaj gjykatës dhe pastaj autorizon pagimin e kompensimit apo tarifës së tillë. Shuma që duhet paguar caktohet nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës gjegjëse dhe saktësohet në autorizimin për pagesë që i dorëzohet Zyrës së Regjistrimit.

Neni 42**Paraqitja e dokumenteve apo provave të tjera fizike**

1. Një palë mund të ofrojë prova fizike duke paraqitur dokumente apo mjete fizike të cilat i posedon ose i kontrollon.

2. Nëse një palë ka apo siguron një dokument që është i rëndësishëm për vërtetimin e një çështje faktike për lëndën apo procedurën, atëherë nga ajo palë kërkohet dorëzimi i dokumentit autentik, ose nëse pala nuk posedon

dokumentin autentik, atëherë dorëzohet një kopje në gjykatë në fazën më të hershme të mundur të procedurave. Kur dorëzohet një kopje, gjyqtari(ët) mund të urdhërojë personin që posedon dokumentin autentik, nëse është i njohur, ta dorëzojë dokumentin autentik në gjykatë apo që të paraqitet në seancë dëgjimore dhe të paraqet dokumentin autentik gjatë dëgjimit.

3. Nëse një palë ka apo siguron një mjet fizik, përveç dokumentit, që është i rëndësishëm për vërtetimin e një çështje faktike për lëndën apo procedurën, atëherë nga ajo palë kërkohet që të dorëzojë mjetin e tillë apo fotografinë e tij në gjykatë në fazën më të mundur të procedurave. Gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës mund të urdhërojë palën e cila posedon mjetin që të paraqesë mjetin e tillë gjatë seancës dëgjimore.

4. Nëse prova për një fakt të veçantë gjendet në një dokument apo mjet fizik që pala beson se është në posedim apo në kontroll të një pale tjetër, atëherë pala mund të parashtrojë një kërkesë me shkrim duke kërkuar nga gjykata që të nxjerrë një urdhër detyrues për palën apo personin tjetër për dorëzimin e dokumentit apo mjetit në gjykatë, ose një dëshmi nën betim ku mohohet që pala apo personi tjetër posedon apo ka nën kontroll dokumentin apo mjetin dhe duhet të sigurojë informata që kjo palë apo person tjetër mund t'i ketë lidhur me vendndodhjen e dokumentit apo mjetit të tillë.

5. Nëse një palë apo person nuk respekton urdhrin e nxjerrë sipas paragrafit 4. të këtij neni dhe dështon të paraqesë dokumentin apo mjetin, ose dështon që t'i përgjigjet urdhrin brenda afatit kohor të përcaktuar me urdhër, atëherë gjykata shqipton gjobot e përcaktuara me paragrafin 6. të nenit 37 dhe paragrafin 6. të nenit 40 të kësaj shtojce.

Neni 43 **Shikimi i terrenit dhe inspektimi i objekteve**

1. Pas parashtimit të një kërkesë nga njëra pale, mund të kërkohet shikimi i terrenit apo inspektimi i një objekti kur fakti që duhet vërtetuar nuk mund të vërtetohet nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit, raporteve të ekspertit apo paraqitjes së dokumenteve apo mjeteve tjera fizike.

2. Pala që ka barrën e dëshmisë paraqet provat që mbliidhen nëpërmjet shikimit të terrenit apo inspektimit të objektit lidhur me një fakt të veçantë, nëpërmjet identifikimit të një vendi apo objekti të caktuar dhe faktit vërtetohet nga shikimi i terrenit apo inspektimi.

3. Nëse vendi apo objekti është në posedim të një personi, i cili nuk është palë në procedurë, atëherë pala që ka barrën e dëshmisë mund të kërkojë nxjerrjen e një urdhri ndaj këtij personi për të lejuar qasjen në vendin apo objektin në fjalë.

Neni 44 **Seancat publike**

Procedurat gojore janë të hapura për qytetarët. Dhoma e Posaçme mund të vendosë për përjashtimin e qytetarëve nga seanca, me kusht që përjashtimi bëhet për shkaqe sigurie të cilësdo palë ose të avokatëve të tyre, ose për shkaqe të sigurisë dhe rendit publik.

Neni 45 **Mbarëvajtja e seancave**

1. Çdo palë, avokat, dëshmitar apo pjesëmarrës tjetër në procedurat verbale, sjellja e të cilit kundrejt Dhomës së Posaçme, një gjyqtari apo Regjistër mbajtësi, ose cilitdo nëpunësi tjetër të Dhomës së Posaçme, nuk është në përputhje me dinjitetin e Dhomës së Posaçme, apo i cili vepron në mënyrë fyese kundrejt palës tjetër apo avokatit të palës tjetër, apo i cili përdor të drejtën e tij apo saj për qëllime tjera nga ato për cilat i janë dhënë, mund të largohet në çdo kohë nga procedura me vendim të Dhomës së Posaçme. Personit në fjalë duhet dhënë mundësia që të paraqesë mbrojtjen e tij apo saj. Urdhri hyn në fuqi menjëherë.

2. Nëse përjashtohet avokati i një pale sipas paragrafit 1. të këtij neni, atëherë procedurat pezullohen për një periudhë kohore të caktuar nga gjyqtari kryesues në mënyrë që palës në fjalë t'i mundësohet caktimi i një avokati të ri.

3. Kryesuesi mund të përjashtojë nga seancat gojore çdo vëzhgues, sjellja e të cilit është në kundërshtim me dinjitetin e Dhomës së Posaçme apo i cili pengon procedurat gojore.

Neni 46

Njoftimi për seancë dëgjimore

1. Palët ftohen në seancën e parë dëgjimore me anë të njoftimit me shkrim. Njoftimi përmban datën, orën dhe vendin e seancës dëgjimore dhe u dorëzohet palëve jo më vonë se dy javë para ditës së seancës dëgjimore.
2. Pas parashtrimit të kërkesës nga ndonjëra palë, Kryesuesi shtyn seancën dëgjimore nëse pala dëshmon se nuk mund të paraqitet në seancë dëgjimore për ndonjë arsye shumë të rëndësishme. Palës tjetër mund t'i jepet mundësia që të paraqesë komente lidhur me kërkesën. Gjyqtari kryesuesi vendos për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe vendimi i tillë u dorëzohet palëve. Nëse miratohet kërkesa për shtyrjen e seancës dëgjimore, gjyqtari kryesuesi mund të urdhërojë palën kërkuese që të paguajë shpenzimet që ajo ia ka shkaktuar palës tjetër apo palëve që kanë pësuar nga shtyrja.

Neni 47

Procedurat gjatë seancës dëgjimore

1. Nën-kolegji kryesohet nga një gjyqtar ndërkombëtar, i cili kryen detyrat që i janë akorduar Kryesuesit me këtë shtojcë. Gjyqtari kryesuesi është përgjegjës për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore. Në fillim të çdo seance dëgjimore, gjyqtari kryesuesi konstaton praninë e palëve dhe avokatëve të tyre.
2. Pala që përfaqësohet në seancë përmes avokatit, mund t'i drejtohet Dhomës së Posaçme vetëm përmes të saj, përveç nëse ndonjë gjyqtar ia parashtron asaj pale një pyetje drejtpërdrejt.
3. Pas hapjes së seancës së parë dëgjimore, gjyqtari kryesuesi paraqitet një hyrje të shkurtër të kërkesës, duke i kushtuar rëndësi të veçantë fakteve kontestuese. Palëve mund t'u jepet mundësia që të bëjnë një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre. Në prezantimin e tyre, palët kufizohen në paraqitjen e fakteve dhe të çështjeve ligjore të cilat janë të rëndësishme për kërkesën.
4. Gjyqtari(ët) pastaj zhvillon procedurat për vlerësimin e dëshmive për mbledhjen dhe shqyrtimin e provave.
5. Palëve do t'u jepet mundësia për paraqitjen e parashtrësive verbale për faktet dhe ligjin që janë të rëndësishme për kërkesën. Dhoma e Posaçme mund të kufizojë kohën që i caktohet secilës palë për paraqitjen e parashtrësive të tilla.
6. Procedura verbale përfundon pasi që palët t'i kenë paraqitur parashtrësit e tyre përmbyllëse. Sa herë që lejojnë rrethanat një gjë të tillë, seancat gojore mbahen gjatë një seance të vetme dëgjimore. Seanca tjera dëgjimore mund të caktohen po qe se nuk ka qenë e mundur që gjatë një dëgjimi të paraqiten të gjitha provat dhe parashtrësit.
7. Regjistër mbajtësi kujdeset që procesverbali fjalë-për-fjalë i të gjitha seancave mbahet dhe regjistrohet nga raportuesi i gjykatës. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga Kryesuesi.
8. Nëse është nxjerr vendimi për t'u liruar nga mbledhja e dëshmive dhe provave tjera në mbështetje të paragrafit 3. të nenit 34 të kësaj shtojce, atëherë palëve u jepet mundësia për paraqitjen e parashtrësive gojore lidhur me ligjin që është i rëndësishëm për kërkesën, dhe në këtë rast nuk zbatohet paragrafi 4. i këtij neni.

KREU XII

AKTGJYKIMI

Neni 48

Aktgjykimi

1. Vendimi i Dhomës së Posaçme me të cilin gjykohet një kërkesë shpallet me një Aktgjykim që duhet të përmbushë kushtet e neneve 10 dhe 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Dhoma e Posaçme e mbështet aktgjykimin e saj në bazë të analizimit të provave, parashtrësive verbale dhe me shkrim që paraqiten gjatë procedurave dhe ligjit të Kosovës në fuqi.
2. Çfarëdo kompensimi që caktohet nga Dhoma e Posaçme nuk do të tejkalojë kompensimin e kërkuar nga Parashtruesi.
3. Nëse pala kundërshtarë e pranon kërkesën, atëherë Dhoma e Posaçme nxjerrë një aktgjykim në dobi të

parashtruesit.

4. Versioni autentik i Aktgjykimit, i nënshkruar nga gjyqtar kryesues i lëndës, vuloset dhe dërgohet në Zyrën e Regjistrimit. Një kopje e aktgjykimit i dorëzohet secilës palë brenda pesë (5) ditë punë pas miratimit të tij.

5. Aktgjykimi është në gjuhën Shqipe dhe Serbe dhe shoqërohet nga një përkthim në gjuhën Angleze.

6. Në përputhje me dispozitat e ligjit të Kosovës në fuqi, aktgjykimi është i detyrueshëm që nga dita e dorëzimit të tij të palët dhe është i zbatueshëm si aktgjykim i formës së prerë i Gjykatës Supreme të Kosovës.

7. Nëse mund të apelohej një Aktgjykim i formës së prerë, atëherë Kolegji i Apelit, me kërkesë të parashtruesit të ankesës, shtyn zbatimin e atij aktgjykimi derisa sa të merret vendimi mbi apelin.

Neni 49 **Korrigjimi i gabimeve administrative**

1. Dhoma e Posaçme, me nismë të saj apo me kërkesën e ndonjë pale të parashtruar brenda afatit dyjavësh pas dorëzimit të Aktgjykimit, mund të korrigjojë çfarëdo gabimi administrativ apo të llogaritjes të bërë në aktgjykim.

2. Urdhri për korrigjim i bashkëngjitet versionit autentik të Aktgjykimit të korrigjuar.

Neni 50 **Lëshimet**

1. Nëse Dhoma e Posaçme bën lëshim dhe nuk merr vendim për ndonjë pjesë të veçantë së një kërkesë apo për shpenzime, cilado palë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të aktgjykimit mund të kërkojë nga Dhoma e Posaçme që ta plotësojë aktgjykimin e saj.

2. Kërkesa për plotësimin e aktgjykimit u dorëzohet palëve kundërshtare dhe gjyqtari kryesues e cakton afatin kohor brenda së cilit palët mund të parashtrojnë argumentet kundërshtuese, nëse kanë ndonjë. Pas mbarimit të afatit kohor të caktuar, Dhoma e Posaçme merr vendim mbi kërkesën.

Neni 51 **Shpallja e vendimeve**

Regjistër mbajtësi shpallë të gjitha Aktvendimet dhe Aktgjykimet që merr kolegji, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm në ueb-faqen e Dhomës së Posaçme. Shpallja do të bëhet në gjuhën Shqipe dhe Serbe si dhe një përkthim në gjuhën Angleze.

KREU XIII **AKTGJYKIMET PËR MOSPARAQITJE**

Neni 52 **Aktgjykimet për mosparaqitje**

1. Nëse pala kundërshtare, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk e parashtron mbrojtjen ndaj kërkesës në mënyrën e duhur brenda afatit kohor të përcaktuar në mbështetje të nenit 29 të kësaj shtojce, ose nëse pala kundërshtare nuk paraqitet në seancë dëgjimore për të cilën është njoftuar sipas rregullit dhe me kohë, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, sipas detyrës zyrtare, apo në bazë të kërkesës së Parashtruesit, mund të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër palës kundërshtare.

2. Nëse parashtrues i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

3. Para nxjerrjes së një aktgjykimi për mosparaqitje, gjyqtari(ët) gjegjës vlerëson nëse kërkesa është e pranueshme dhe nëse faktet e pretenduara nga Parashtruesi mbështesin kërkesën.

4. Aktgjykimi për mosparaqitje është i ekzekutueshëm si aktgjykim i formës së prerë, përveç nëse apo derisa ai prishet

në mbështetje të nenit 53 të kësaj shtojce. Kundër aktgjykimit për mosparaqitje nuk mund të parashtrahet ankesë.

5. Dhoma e Posaçme mund ta shtyjë ekzekutimin e aktgjykimit për mosparaqitje deri në nxjerrjen e vendimit të saj për çfarëdo kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje.

Neni 53 **Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje**

1. Cilado palë kundër së cilës është nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje nga Dhoma e Posaçme, mund të parashtrrojë një kërkesë në Dhomën e Posaçme për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje.

2. Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje duhet të parashtrohet brenda një muaji nga dita e dorëzimit të aktgjykimit për mosparaqitje te pala gjegjëse. Kërkesa u dorëzohet palëve tjera.

3. Pas dorëzimit të kërkesës, gjyqtari kryesuesi përcakton një afat kohor brenda së cilit pala tjetër mund të paraqet argumentet kundërshtuese me shkrim, nëse ka ndonjë.

4. Në nxjerrjen e Aktvendimit të saj mbi kërkesën për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje, Dhoma e Posaçme:

4.1. vërteton Aktgjykimin për mosparaqitje dhe hedhë poshtë kërkesën për prishjen e tij, ose

4.2. prishë aktgjykimin për mosparaqitje dhe urdhëron vazhdimin e procedurave.

5. Një aktvendim mbi kërkesën për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje i bashkëngjitet versionit autentik të Aktgjykimit për mosparaqitje dhe një kopje e atij aktvendimi u dorëzohet palëve.

6. Ndaj aktvendimit mbi kërkesën për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje mund të parashtrahet ankesë.

KREU XIV **MJETET E PËRKOHSHME JURIDIKE**

Neni 54 **Pezullimi i zbatimit të një gjobe**

Me kërkesë të palës për ta anuluar gjobën e shqiptuar nga Agjencia në mbështetje të nenit 27 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Dhoma e Posaçme mund ta pezullojë zbatimin e një gjobe në pritje të një aktvendimi të formës së prerë lidhur me kërkesën.

Neni 55 **Urdhri paraprak gjyqësor**

1. Pas parashtrimit të një kërkesë nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një urdhër paraprak gjyqësor me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet një urdhër paraprak gjyqësor. Dëmi konsiderohet si i 'pariparueshëm' vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Shkresa për një urdhër paraprak gjyqësor duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë.

2. Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me shkresën për një urdhër paraprak gjyqësor pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim. Kur ekzistojnë rrethana urgjente që detyrojnë Dhomën e Posaçme të veprojë menjëherë lidhur me shkresën, atëherë Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim për shkresën mbi urdhrin paraprak gjyqësor pa ia dorëzuar shkresën palës tjetër. Urdhri paraprak gjyqësor lëshohet vetëm për një periudhë kohore të caktuar dhe mund të zgjatet pas parashtrimit të kërkesës.

3. Vendimi për një urdhër paraprak gjyqësor bëhet me shkrim dhe do të:

3.1. përmbledhë prapavijën faktike dhe procedurale të procedurës, për aq sa ato kanë të bëjnë me urdhrin paraprak gjyqësor;

3.2. konstatojë natyrën e dëmit që do ta pësojë pala parashtruese në rast se nuk lëshohet urdhri paraprak gjyqësor dhe arsyet se përse Dhoma e Posaçme ka konstatuar që dëmi i tillë është i pariparueshëm;

3.3. përfshijë gjetjet e Dhomës së Posaçme mbi faktet dhe arsyetimin ligjor për miratimin e urdhrin paraprak gjyqësor; si dhe

3.4. saktësojë kohën se kur skadon urdhri paraprak gjyqësor.

4. Para nxjerrjes të një urdhri paraprak gjyqësor, Dhoma e Posaçme mund t'i kërkojë parashtruesit të depozitohet garanci financiare në Dhomën e Posaçme në shumën që Dhoma e Posaçme e konsideron se është të mjaftueshme për kompensimin e shpenzimeve dhe dëmeve që mund t'i pësojë apo mund t'i shkaktohen cilëndo palë që i nënshtrohet urdhrin paraprak gjyqësor e që më pas konstatohet se gabimisht i është nënshtruar urdhrin paraprak gjyqësor.

5. Vendimi për lejimin e mjetit juridik, urdhrin paraprak gjyqësor, për një palë është i detyrueshëm për të gjitha palët dhe kundër tij mund të parashtrohet anekese menjëherë në Kolegjin e Apelit.

KREU XV SHPENZIMET

Neni 56 Vendimi për shpenzimet

1. Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve.

2. Pala e pasuksesshme urdhërohet të t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me Aktgjykimin e formës së prerë. Nëse ka disa palë të pasuksesshme, atëherë Dhoma e Posaçme vendos lidhur me ndarjen e shpenzimeve.

3. Në rastet kur secila palë ka sukses në disa kërkesa dhe dështon në disa të tjera, ose në rrethana të jashtëzakonshme, Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë që shpenzimet të ndahen apo që palët t'i bartin vetë shpenzimet e tyre.

4. Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë një palë, edhe nëse ka qenë e suksesshme, që të paguajë shpenzimet që Dhoma e Posaçme konsideron se kjo palë në mënyrë të paarsyeshme ia ka shkaktuar palës tjetër.

5. Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bart shpenzimet e veta. Në rastet kur kërkesa nuk vazhdon me një Aktgjykim, shpenzimet ndahen sipas marrëveshjes së palëve, ose nëse nuk ato pajtohen, Dhoma e Posaçme ka lirinë e veprimit për ndarjen e shpenzimeve.

Neni 57 Llogaritja e shpenzimeve

1. Llogaritja e shpenzimeve përfshin shpenzimet e gjykatës, pagesën e arsyeshme për avokatin, kompensimin për humbjen e fitimit të dëshmitarëve, pagesën e arsyeshme për ekspertët, shpenzimet për udhëtim dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme për dëshmitarët dhe ekspertët.

2. Shpenzimet e gjykatës që mund t'iu shqiptohen palëve përcaktohen me një plan me shkrim të shpenzimeve nga Presidiumi dhe i dorëzohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim. Plani i shpenzimeve hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

KREU XVI PROCEDURAT E ANKESËS

Neni 58 Dispozitat e përgjithshme

1. Siç përcaktohet me paragrafin 6. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, një palë ka të drejtën e ankesës drejtpërdrejt në Kolegjin e Apelit kundër çfarëdo Aktvendimi apo Aktgjykimi të një gjyqtari të vetëm, nën-kolegji apo

kolegji të specializuar, ose gjykate së cilës i është referuar një kërkesë, çështje, procedurë apo lëndë në mbështetje të paragrafit 4. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

2. Rregullorja e punës dhe provat që rregullojnë Kolegjet e Specializuar zbatohen *mutatis mutandis* për procedurat e ankesës para Kolegjit të Apelit. Kryesuesi i Kolegjit të Apelit, në konsultim me Presidiumin, mund të lëshojë udhëzime mbi praktikën që adreson aspektet e hollësishme për zhvillimin e procedurave para Kolegjit të Apelit.

Neni 59 Parashtrimi i ankesës

1. Pala e cila parashtron një ankesë paraqet dhe dorëzon ankesën në mënyrën dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 6. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe atë brenda afatit kohor të saktësuar në atë paragraf.

2. Pas pranimit të njoftimit për apelin, gjykata, Kolegji i Specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm që ka nxjerrë Aktvendimin apo Aktgjykimin gjegjësisht ia dorëzon shkresat e lëndës Kolegjit të Apelit.

Neni 60 Përmbajtja e ankesës

1. Njoftimi për ankesën duhet të:

- 1.1. identifikojë lëndën apo procedurën për të cilën është marrë Aktgjykimi apo Aktvendimi që i nënshtrohet ankesës;
- 1.2. përfshijë emrin e ankuesit dhe emrin dhe adresën e agjentit të ankuesit;
- 1.3. përfshijë emrat e palëve tjera dhe emrat dhe adresat e agjentëve të palëve tjera;
- 1.4. paraqet datën kur ankuesit i është dorëzuar Aktvendimi apo Aktgjykimi që i nënshtrohet ankesës;
- 1.5. paraqet një përmbledhje shumë të shkurtër për llojin e ankesës;
- 1.6. përmbajë një kopje të Aktvendimit apo Aktgjykimin që i nënshtrohet ankesës.
- 1.7. saktësojë emrin dhe numrin e lëndës që mund t'i jetë caktuar nga Kolegji i Apelit në ankesë;
- 1.8. paraqet në hollësi çështjen (et) që parashtrihen në ankesë dhe argumentet ligjore të ankuesit lidhur me këto çështje;
- 1.9. paraqet në hollësi llojin e zhdëmtimit të kërkuar nga ankuesi, duke marrë parasysh dispozitat e paragrafit 10. dhe 11. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe të nenit 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

2. Brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të apelit, Kolegji i Apelit merr vendim siç përcaktohet me paragrafin 9. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Nëse Kolegji i Apelit vendos që ankesa nuk meriton të shqyrtohet, atëherë Kolegji hedh poshtë ankesën duke marrë dhe duke dorëzuar një Aktvendim përderisa është në përputhje me kushtet e paragrafit 9. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Nëse merret një Aktvendim i tillë, atëherë përfundojnë procedurat e ankesës. Nëse Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa meriton të shqyrtohet, atëherë ai merr dhe ai dorëzon Aktvendimin palëve.

Neni 61 Përgjigja ndaj ankesës

1. Siç përcaktohet me paragrafin 8. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, cilado palë mund ta parashtrijë një përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit brenda njëzet e një (21) ditëve pasi kësaj pale t'i jetë dorëzuar memorandum i ligjor i parashtruesit të ankesës.

2. Përgjigja e tillë duhet të:

- 2.1. saktësojë emrin dhe numrin e lëndës që mund t'i jetë caktuar nga Kolegji i Apelit në ankesë;
- 2.2. përfshijë emrin e palës kundërshtare dhe emrin dhe adresën e agjentit të palës kundërshtare;

- 2.3. përfshijë emrat e parashtruesve të ankesës dhe palëve tjera dhe emrat dhe adresat e agjentëve të tyre;
- 2.4. paraqet datën kur palës kundërshtare i është dorëzuar apeli;
- 2.5. paraqet në hollësi argumentet ligjore të palës kundërshtare që i përgjigjen atyre të paraqitura në apel;
- 2.6. paraqet në hollësi llojin e zhdëmtimit të kërkuar nga pala kundërshtare, duke marrë parasysh dispozitat e paragrafit 10 dhe 11 të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe të nenit 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Neni 62

Përgjigja e apeluesit dhe kundërpërgjigja e palës kundërshtare

Siç përcaktohet me paragrafin 8. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashtruesi i ankesës ka njëzet e një (21) ditë afat, pas dorëzimit të një përgjigjeje kundër memorandumit të tij ligjor, që të parashtrorë dhe të dorëzojë përgjigjen e tij ndaj asaj përgjigjeje; dhe nëse apeluesi parashtron një përgjigje të tillë, atëherë pala kundërshtare ka njëzet e një (21) ditë afat, pas dorëzimit të përgjigjes së apeluesit, që të parashtrorë përgjigjen ndaj kundërpërgjigjes së palës tjetër.

Neni 63

Përfundimi i procedurave ankuese me shkrim

1. Procedurat apeluese me shkrim përfundojnë:

- 1.1. nëse asnjëra palë nuk dorëzon me kohë një përgjigje ndaj apelit të apeluesit, gjegjësisht deri në mesnatën e datës kur mbushen njëzet e një (21) ditë, pasi që të gjitha palëve tjera t'i jetë dorëzuar apeli.
- 1.2. nëse njëra apo më shumë palë me kohë kanë dorëzuar një përgjigje ndaj apelit, por apeluesi nuk ka dorëzuar me kohë çfarëdo përgjigje ndaj asaj, gjegjësisht deri në mesnatën e datës kur mbushen njëzet e një (21) ditë, pasi që apeluesit t'i jenë dorëzuar me kohë të gjitha përgjigjet ndaj apelit të tij.
- 1.3. nëse apeluesi me kohë ka dorëzuar një përgjigje ndaj përgjigjes së palës tjetër ndaj apelit të tij, gjegjësisht deri në mesnatën e datës pas së cilës nuk mund të parashtrorë asnjë kundërpërgjigje.

Neni 64

Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrorë nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrorë para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
2. Gjatë seancë dëgjimore me gojë, kolegji i apelit kryesohet nga gjyqtari kryesues. Kryesuesi është përgjegjës për mbarëvajtjen e seancës. Në fillim të çdo seance dëgjimore, Kryesuesi përcakton praninë e palëve dhe avokatëve të tyre.
3. Pala që përfaqësohet në seancë përmes avokatit, mund t'i drejtohet Kolegjit të Apelit vetëm përmes atij, përveç nëse ndonjë anëtar i Kolegjit të Apelit ia parashtron asaj pale një pyetje drejtpërdrejt.
4. Pas hapjes së seancës me gojë, gjyqtari kryesues paraqet një hyrje të shkurtër të ankesës, çështjeve ligjore të kontestuara dhe çfarëdo gjetje faktike të konstatuar nga vendimmarrësi i Aktvendimit apo Aktgjykimit gjegjës, për të cilin pala pretendon se është "qartazi i pasaktë".
5. Në dëgjimin me gojë, palëve mund u jepet mundësia për të bërë një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre ligjore. Palët kufizojnë prezantimet e tyre në faktet dhe provat që pasqyrohen në shënimet që janë të rëndësishme për ankesën dhe çështjet ligjore që janë të rëndësishme për ankesën. Kolegji i Apelit mund të caktojë një afat të arsyeshëm kohor për secilën palë për prezantimet e tilla.
6. Përveç nëse lejohet në mënyrë të veçantë në bazë të nenit 65 të kësaj shtojce, gjyqtari(ët) nuk do të nis procedurat për vlerësimin e provave.

7. Regjistër mbajtësi kujdeset që procesverbali fjalë-për-fjalë i të gjitha seancave mbahet dhe regjistrohet nga raportuesi i gjykatës. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga Kryesuesi.

Neni 65 **Paraqitja e provave të reja**

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmojnë mirë, Kolegji i Apelit mund t'i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t'i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t'i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Neni 66 **Zgjidhja e apelit**

Kolegji i Apelit mund të zgjidhë një apel duke ndërmarrë njërin prej veprimeve të përcaktuara me paragrafin 10. të nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Neni 67 **Shpenzimet**

1. Në Aktvendimin apo Aktgjykimin e tij lidhur me ankesën, Kolegji i Apelit merr një vendim lidhur me shpenzimet procedurale për shkallën e parë dhe atë të apelit. Dispozitat e neneve 56 dhe 57 të kësaj shtojce zbatohen *mutatis mutandis*.

2. Në vendimin e tij për shpenzimet, Kolegji i Apelit llogarit ndarazi shpenzimet për procedurat për shkallën e parë dhe atë të apelit.

KREU XVII **ANKESAT SIPAS PARAGRAFIT 1.6 TË NENIT 4** **TË LIGJIT PËR DHOMËN E POSAÇME**

Neni 68 **Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime**

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e Posaçme i zbaton *mutatis mutandis* nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.

2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.

3. Njoftimi për qytetarët, që u përmend në paragrafin 2. të këtij neni, përmban një kopje të formularit për plotësimin e një kërkesë dhe/apo kundërshtimi. Formulari i tillë përmban informata që duhet paraqitur për t'i mundësuar Agjencisë vlerësimin e kërkesës dhe/apo të kundërshtimit.

4. Pas pranimit të ndonjë kërkesë dhe/apo kundërshtimi lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, Agjencia mund të kërkojë nga parashtruesi që të sigurojë prova shtesë dhe/apo informata që janë të nevojshme për t'i mundësuar Agjencisë vlerësimin e mirëfilltë të kërkesës dhe/apo të kundërshtimit. Agjencia mund të merr vendim për zhvillimin e procedurës për vlerësimin e provave, që do të jetë zyrtarisht i regjistruar, për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të japin dëshminë apo të paraqesin prova tjera. Pas ofrimit të një mundësie të arsyeshme për dhënien e dëshmisë dhe paraqitjes së provave, Agjencia lejon cilindo person apo avokatin e tij/saj për të paraqitur argumentet në mbështetje të kërkesës dhe/apo të kundërshtimit.

5. Pas adresimit zyrtar të të gjitha kërkesave dhe kundërshtimeve, Agjencia – nëse është e nevojshme – rregullon listën e punësuarve me të drejta legjitime, dhe nëpërmjet një vendimi të Bordit të vet të Drejtorëve në përputhje me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall zyrtarisht listën përfundimtare të punësuarve me të drejta legjitime. Ky vendim do të përmbajë një shpjegim të arsyetuar:

5.1. për përfshirjen e cilitdo person në listë;

5.2. për përjashtimin e cilitdo person në listë, i cili ka qenë në listën paraprake të shpallur;

5.3. për refuzimin për përfshirjen e një personi i cili ka kërkuar të përfshihet në një listë të tillë, pas shpalljes origjinale; si dhe

5.4. për pranimin apo refuzimin e ndonjë kundërshtimi tjetër ndaj listës.

6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas ditës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.

7. Ankesa e tillë dorëzohet me shkrim në Dhomën e Posaçme para skadimit të afatit kohor njëzet (20) ditor dhe ajo do të:

7.1. përmbajë emrin e personit apo emrat e personave të cilët parashtrojnë ankesën apo në emër të atyre që ankesa parashtrohet;

7.2. përmbajë emrin dhe adresën e secilit agjent të personave;

7.3. përfshijë një deklaratë të hollësishme për faktet që mbështetin ankesën, si dhe

7.4. përfshijë një deklaratë të hollësishme për argumentet ligjore që mbështetin një ankesë të tillë.

8. Një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Agjencisë nga Regjistër mbajtësi i Dhomës së Posaçme brenda pesë (5) ditëve të punës pasi që të jetë parashtruar në Dhomën e Posaçme.

9. Agjencia ka cilësinë e palës kundërshtare për çdo lëndë apo procedurë që bazohet në një ankesë të tillë. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas pranimit të një ankese të tillë, Agjencia do t'ia dorëzojë Dhomës së Posaçme përgjigjen e saj ndaj ankesës së bashku me të gjithë dokumentacionin që posedon Agjencia e që drejtpërdrejt lidhet me krijimin nga ana e saj të një liste të tillë. Agjencia do ta dorëzojë përgjigjen e vet dhe dokumentet e tilla gjuhën e ankesës së bashku me një përkthim në gjuhën Angleze të përgjigjes dhe dokumenteve të tilla..

10. Një kopje e përgjigjes dhe dokumenteve që parashtrohen nga Agjencia do t'i dorëzohen ankuesit(ve) nga Regjistër mbajtësi i Dhomës së Posaçme brenda pesë (5) ditë pune, pas dorëzimit të shkresave të tyre në Dhomën e Posaçme.

11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkesë me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seancave gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seance gojore, atëherë Kolegji Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t'i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.

12. Dhoma e Posaçme aranzhon, nëse është e nevojshme, përkthimin e ankesës në gjuhën angleze dhe çfarëdo shkresë tjetër që parashtrohet nga ankuesi. Përkthimet e tilla do t'iu dorëzohen ankuesit(ve) dhe Agjencisë sa më shpejt që është e mundur. Nëse mbahet një seancë dëgjimore ku dokumentet në fjalë do të diskutohen, atëherë seanca e tillë do të mbahet jo më herët se shtatë (7) ditë pasi që dokumentet e përkthyer t'i jenë dorëzuar palëve.

13. Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar merret dhe i dorëzohet ankuesit(ve) dhe Agjencisë jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas datës kur ankesa është dorëzuar në Dhomën e Posaçme. Të gjitha Aktvendimet dhe Aktgjykimet e

kolegjeve të specializuara mund të apelohe në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe të kësaj shtojce.

14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

KREU XVIII PROCEDURAT PËR RIORGANIZIM DHE LIKUIDIM

Neni 69 Procedurat për riorganizim dhe likuidim

Procedurat për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë, ose paraardhësit të saj (AKM-së), një administratori apo komisioni për likuidim në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 apo çfarëdo legjislacioni pasues do të rregullohen nga rregullorja apo legjislacioni pasues (cilitdo që është në fuqi). Në shkallë të parë, zhvillimi i lëndës apo procedurës lidhur me kundërshtime të tilla do t'i caktohet Kolegjit të Specializuar që merret me çështjet brenda fushëveprimit të nën-paragrafit 8.5. të nenit 3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Sa i përket çështjeve që nuk mbulohe me rregulloren e tillë apo me legjislacionin pasues, do të zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat më të përshtatshme të kësaj shtojce dhe Kolegji i Specializuar rregullisht do t'ia delegojë zhvillimin e procedurave gjyqtarit të vetëm, i cili ka ekspertizë të veçantë në lidhje me çështjet e tilla.

Neni 70 Shqyrtimi i vendimeve të komisionit për likuidim

1. Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose aseti sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni.

2. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (3) ditëve pas pranimit të vendimit. çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

3. Në shkallë të parë, zhvillimi i lëndës apo procedurës lidhur me ankesa të tilla do t'i caktohet Kolegjit të Specializuar që merret me çështje të likuidimit.

4. Dispozitat e tjera të përgjithshme procedurale në nenet 13-67 të kësaj Shtojce zbatohen për lëndët dhe procedurat bazuar në ankesa të tilla. Kolegji, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm mund të nxjerrë një Aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin dhe ndryshimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit.